



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

GJENDJA AKTUALE E INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS



Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autorë: Plator Avdiu dhe Shpat Balaj

Redaktor i brendshëm: Mentor Vrajolli

Shënim: Ky raport, në formën e tij origjinale, është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, dhe versionet e tija të plotësuara dhe ndryshuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo mjet tjetër, pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.



Fondacioni i Kosovës
për Shoqëri të Hapur

Ky publikim mbështetet nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në kuadër të projektit "Fuqizimi i integritetit në Policinë e Kosovës". Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë përgjegjësi vetëm e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS-it.



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

GJENDJA AKTUALE E INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS

**Prishtinë
Dhjetor 2020**

Tabela e përmbajtjes

LISTA E SHKURTESAVE	1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.	2
HYRJE	3
1.KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËR INTEGRITET.	5
1.1. Dispozitat kushtetuese për sundimin e ligjit.	5
1.2. Korniza ligjore në fushën e procedurës penale.	6
1.3. Legjislacioni për parandalimin e korrupsionit	7
1.4. Legjislacioni për zyrtarët publikë / zyrtarët e lartë publikë.	9
2.LEGJISLACIONI PËR INTEGRITETIN NË POLICINË E KOSOVËS.	12
2.1. Korniza ligjore e Policisë së Kosovës.	12
2.1.1. Aktet nënligjore të Policisë së Kosovës	15
3.DOKUMENTET STRATEGJIKE PËR NGRITJEN E INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS. . .	17
3.1. Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës.	17
3.1.1. Mangësitë kryesore të Planit për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës. .	20
3.2. Plani Zhvillimor Strategjik	21
3.3. Strategjia e Policimit në Bashkësi.	22
4.IMPLIKIMET NË INTEGRITET NGA ASPEKTET ORGANIZATIVE TË PK-SË.	23
4.1. Kontrolli i brendshëm.	24
4.1.1. Një përmbledhje e administrimit të rasteve disiplinore nga mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme.	25
4.2. Ushtrimi i pozitave zyrtare.	27
4.2.1. Pezullimi i pozitave si konflikt i mundshëm i interesit	30
4.3. Menaxhimi i buxhetit	32
4.4. Pengesat për kujdesin shëndetësor.	33
REKOMANDIME	35

LISTA E SHKURTESAVE

AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
DSP	Divizioni për Standardet Profesionale
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KBD	Komisioni i Brendshëm Disiplinor
LPA	Lista e Personelit të Autorizuar
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PK	Policia e Kosovës
PLANI I INTEGRITETIT	Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës
PZHS	Plani Zhvillimor Strategjik
SPB	Strategjia e Policimit në Bashkësi
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- Përgjithësisht, Kosova ka ndërtuar kornizë të mirë kushtetuese dhe ligjore kundër korrupsionit dhe përsundimin e ligjit. Sidoqoftë, marrë parasysh që ende nuk janë rregulluar dhe miratuar plotësisht ndryshimet ligjore për sinjalizimin dhe deklarimin e pasurisë, kanë mbetur ende sfida që duhen adresuar. Mungesa e vullnetit politik, e shoqëruar edhe nga kriza e vazhdueshme politike, ka pasur ndikim të rëndësishëm negativ në këtë drejtim.
- Kohët e fundit Policia e Kosovës ka ndërmarrë një hap pozitiv duke bërë publikimin e legjislacionit dytësor, gjë që ka qenë një nga rekomandimet kyçe të aktiviteteve avokuese të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë për rritjen e transparencës së policisë.
- Mekanizmat e kontrollit të brendshëm të Policisë së Kosovës kanë identifikuar një numër të lartë të ankesave të pabazuara të parashtruara në këto mekanizma gjatë vitit 2019. Për pasojë, gjasat janë të mëdha të ketë pasiguri në lidhje me procedurat e raportimit dhe përpunimit të ankesave, qoftë nga qytetarët ose nga vetë zyrtarët policorë;
- Shifrat e personelit të departamenteve të Policisë së Kosovës nuk përputhen me shifrat e dhëna në Listën e Personelit të Autorizuar, rrjedhimisht shumë departamente brenda policisë përballen me mungesa në burimet njerëzore. Sidoqoftë, kjo gjetje del nga raporti më i fundit i disponueshëm për inspektimin e burimeve njerëzore nga Inspektorati Policor i Kosovës, statistikat më të fundit të të cilit datojnë nga viti 2017. Ekipi hulumtues i QKSS-së ka kërkuar statistika të përditësuara nga Zyra për Informim e Policisë së Kosovës, por deri në datën e këtij raporti (dhjetor 2020), por nuk ka marrë asnjë përgjigje;
- Policia e Kosovës përballlet me shpërndarje joadekuate të gradave në departamentet e veta dhe disa departamente përballen me mungesa në plotësimin e pozitave me gradat adekuate, ndërsa departamente të tjera e kanë tejkaluar numrin e gradave të parapara në disa pozita;
- Policia e Kosovës e ka përmirësuar ekzekutimin e buxhetit të vet në vitin 2020. Sidoqoftë, shumica e kontratave për shpenzime kapitale në vitet 2019-2020 - të cilat më parë ishin burim i sfidave në ekzekutimin e buxhetit - janë dokumente të klasifikuara, dhe si të tilla nuk janë audituar. Kjo tregon priirjen për klasifikim të tepruar të kontratave të prokurimit, duke krijuar kështu hapësirë për keqpërdorime të mundshme të ciklit të prokurimit;
- Mosmiratimi i ligjit për pension të parakohshëm dhe ligjit për trajtimin e invaliditetit vazhdon të sfidojë efektivitetin e Policisë së Kosovës. Në mungesë të këtyre ligjeve, shumë zyrtarë policorë me probleme të rënda shëndetësore dhe me kapacitete të kufizuara për kryerjen e detyrave të tyre, janë të detyruar të vazhdojnë angazhimin e tyre në Policinë e Kosovës;
- Efektet e Planit të Integritetit të Policisë janë minimizuar edhe nga mospërfshirja e mekanizmave të jashtëm të mbikëqyrjes së Policisë së Kosovës në hartimin e tij, marrë parasysh rolin që luajnë mekanizmat e tillë në mbikëqyrjen e çështjeve për integritetin në Policinë e Kosovës.

HYRJE

Viteve të fundit, praktikat e integritetit të sektorit të sigurisë së Kosovës, në veçanti ato të Policisë së Kosovës, kanë hasur në sfida të ashpra, të cilat janë rënduar nga pandemia aktuale e Covid-19 me të cilën po ballafaqohet vendi. Zyrtarë të shumtë policorë u janë nënshtruar hetimeve penale nga mekanizmat përkatës të sundimit të ligjit (Inspektorati Policor i Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit) për vepra të pretenduara penale në lidhje me shkelje të procedurave ligjore që rregullojnë detyrat e tyre zyrtare. Në anën tjetër, vendimi i kryeministrit të Kosovës i marrë në tetor 2020 për shkarkimin e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, ia ka hapur rrugën ndikimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë politik nga partitë në pushtet mbi Policinë e Kosovës. Për më tepër, kjo mund të ketë ndikim të dukshëm në dekurajimin e reformave strukturore në polici, veçanërisht në menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ky punim pasqyron legjislacionin aktual, instrumentet ligjore dhe procedurat ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, si dhe një analizë që synon identifikimin e hendekëve dhe mangësive në kornizën aktuale ligjore në këtë drejtim. Fakti që institucionet e Kosovës nuk kanë arritur ta përmirësojnë legjislacionin kundër korrupsionit sa i përket deklarimit të pasurisë dhe të miratojnë legjislacionin dytësor për sinjalizuesit, tregon mungon përkushtimi dhe të vullnetit politik për forcimin e integritetit të institucioneve shtetërore, përfshirë Policinë e Kosovës. Në këtë pjesë mbi kornizën ligjore, raporti analizon legjislacionin për çështjet e integritetit dhe kundër korrupsionit të lidhura në mënyrë specifike me Policinë e Kosovës. Ligji për Policinë dhe legjislacioni dytësor i Policisë së Kosovës përcaktojnë parimet e integritetit dhe procedurën e standardizuar të Policisë së Kosovës. Procesi i hartimit të Rregullores për Integritetin në Policinë e Kosovës është iniciuar, por deri më tash (dhjetor 2020) nuk ka informacion nëse Rregullorja është miratuar nga institucionet përkatëse.

Gjithashtu, raporti ka analizuar dokumentet strategjike dhe planit aktual për integritetin të Policisë së Kosovës, duke theksuar se ky i fundit është i vjetruar dhe nuk është azhurnuar ende. Është e rëndësishme të theksohet se nuk ka informacion nëse plani i veprimit dhe masat e këtij dokumenti strategjik për zvogëlimin e korrupsionit dhe rritjen e integritetit institucional janë zbatuar në praktikë nga Policia e Kosovës. Plan i ri për integritetin i Policisë së Kosovës pritet të iniciohet në vitin 2021.

Krahas këtyre çështjeve, raporti shqyrton edhe aspektet organizative të Policisë së Kosovës nga perspektiva e integritetit dhe në këtë pjesë adresohen edhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm të policisë dhe rastet disiplinore për sjellje të pahijshme të zyrtarëve policorë. Në këtë drejtim, janë evidentuar shumë sfida në lidhje me shpërndarjen e gradave në kuadër të policisë. Një problem tjetër madhor i analizuar është çështja e pezullimit të pozitave, e cila potencialisht mund të çojë në konflikt interesi të zyrtarëve policorë me grada të ndryshme. Ndërkohë, ka ende sfida në menaxhimin e buxhetit dhe çështjet e lidhura me kujdesin shëndetësor, pasi zyrtarët policorë ende nuk posedojnë sigurime shëndetësore ose të jetës.

Marrë parasysh gjendjen e praktikave të integritetit në Policinë e Kosovës, ky raport i adreson Policisë së Kosovës një pako rekomandimesh specifike për forcimin e

HYRJE

integritetit, duke synuar zhvillimin profesional të institucionit dhe avancimin e masave kundër korrupsionit.

1. KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËR INTEGRITET

Kjo pjesë e raportit shqyrton në mënyrë të përgjithshme legjislacionin aktual të Kosovës kundër korrupsionit dhe për fushën e integritetit, në aspektin e luftimit të korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe sundimit të ligjit në vend. Këtu ofrohet një analizë e shkurtër e dispozitave kushtetuese që përbëjnë bazën kyçe për legjislacionin pasues të Kosovës në fushën e sundimit të ligjit dhe kundër korrupsionit. Kjo nënkupton që Policia e Kosovës (PK), si institucion i sundimit të ligjit u nënshtrohet rregullave të përgjithshme që rrjedhin nga Kushtetuta e Kosovës, legjislacioni parësor dhe dytësor, në të njëjtën mënyrë si institucionet e tjera të sundimit të ligjit dhe drejtësisë (Gjykatat, Prokuroria etj.).

Andaj, para zbërthimit specifik të kornizës ligjore të PK-së, është shumë e rëndësishme që së pari të shqyrtohet legjislacioni i Kosovës kundër korrupsionit dhe korniza përkatëse, e cila siguron një sërë rregullash për PK-në për të ndërtuar dhe ruajtur integritetin duke forcuar llogaridhënien, paanshmërinë dhe transparencën, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë institucionit.

1.1. Dispozitat kushtetuese për sundimin e ligjit

Në këtë drejtim, sundimi i ligjit, lufta kundër veprimtarive të paligjshme dhe kriminale, përfshirë korrupsionin dhe konfliktin e interesit, të cilat janë objektivat kryesore të këtij raporti, janë të sanksionuara dhe përgjithësisht të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Neni 3 përcakton se Kosova qeveriset në mënyrë demokratike duke respektuar sundimin e ligjit përmes institucioneve të saj legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.¹ Kjo dispozitë thekson edhe se ushtrimi i autoritetit publik në Kosovë bazohet në parimet e barazisë së të gjithë individëve para ligjit.² Për më tepër, neni 7 i Kushtetutës shprehet se rendi kushtetues i Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.³ Përveç kësaj, janë edhe dispozitat që përcaktojnë barazinë e të gjithë individëve para ligjit dhe që të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim.⁴ Shkurtimisht, marrë parasysh faktin se Kushtetuta është miratuar relativisht kohët e fundit (krahasuar

1 Paragrafi 1 i nenit 3, Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

2 Po aty, paragrafi 2 i nenit 3.

3 Po aty, paragrafi 1 i nenit 7.

4 Po aty, paragrafi 1 i nenit 24.

me Kushtetutat e tjera në rajon), ajo përmban garanci të forta në lidhje me të drejtat e njeriut dhe llogaridhënien institucionale.

1.2. Korniza ligjore në fushën e procedurës penale

Sa i përket kornizës ligjore, Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074,⁵ i cili hyri në fuqi në vitin 2019, ka një kapitull specifik të titulluar “Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare”. Bazuar në këtë dokument ligjor, dispozitat e pjesës së përgjithshme të Kodit janë të zbatueshme ndaj të gjitha veprave penale të përcaktuara në ligjet e Kosovës. Kodi Penal njih lloje të ndryshme të veprave penale në lidhje me korrupsionin zyrtar, përfshirë konfliktin e interesit siç tregohet më poshtë: keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 414); keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik (neni 415); keqpërdorimi i informatës zyrtare (neni 416); konflikti i interesit (neni 417); përvetësimi në detyrë (neni 418); mashtrimi në detyrë (neni 419); përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 420); pranimi i ryshfetit (neni 421); dhënia e ryshfetit (neni 422); dhënia e ryshfetit zyrtarit të huaj publik ose personave të huaj zyrtarë (neni 423); ushtrimi i ndikimit (neni 424); nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 425); zbulimi i fshehtësisë zyrtare (neni 426); falsifikimi i dokumentit zyrtar (neni 427); arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (neni 428); përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 429); dhe mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (neni 430).

Nga ana tjetër, një ligj tjetër i dizajnuar për luftimin e korrupsionit në vend është Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar i miratuar në vitin 2016 nga Kuvendi i Kosovës, i cili përcakton funksionet dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.⁶ Kjo agjenci operon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë⁷ dhe vepron si mekanizëm i pavarur dhe i qëndrueshëm për administrimin profesional dhe mbajtjen në përkujdesjen e duhur në mirëbesim të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara brenda Kosovës, si dhe nga detyrimet e vendit ndaj vendeve të tjera.⁸

Kurse Ligji Nr. 06/L-087 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë i miratuar në vitin 2018, specifikon kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë në rastet kur procedurat e detajuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës nuk janë të mjaftueshme.⁹ Përveç kësaj, ligji zbaton Direktivën 2014/42/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 3 prillit 2014, për ngrirjen dhe konfiskimin

5 Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

6 Neni 1, Ligji Nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12360>.

7 Po aty, paragrafi 1 i nenit 5.

8 Po aty, paragrafi 3 i nenit 5.

9 Paragrafi 1 i nenit 1, Ligji nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18337>.

e instrumenteve dhe të ardhurave nga krimi në Bashkimin Evropian.¹⁰ Siç përcaktohet nga ky ligj, konfiskimi i zgjeruar zbatohet për pasuritë e personave të cilët janë dënuar për një vepër penale siç përcaktohet nga Kodi Penal i Republikës së Kosovës ose ligje të tjera. Bazuar në këtë përkufizim, konfiskimi është konfiskimi i përhershëm i pasurisë, i urdhëruar me një vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente në përputhje me këtë ligj.¹¹

1.3. Legjislacioni për parandalimin e korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsionit e Kosovës (AKK) ka një numër detyrash specifike ligjore në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, me theks të veçantë në raportimin, zbulimin dhe hetimin e korrupsionit, si dhe për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit.¹² Sipas Ligjit Nr. 03/L-159 për AKK-në, ky institucion është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.¹³ Ai raporton për punën e tij në Kuvendin e Kosovës një herë në vit dhe në komisionin përkatës të Kuvendit çdo gjashtë muaj.¹⁴ Sidoqoftë, fushëveprimi i saj është i kufizuar në procedurat e hetimit paraprak dhe aspektet administrative.¹⁵ Përveç disa përgjegjësi në luftimin e korrupsionit, agjencia mbikëqyrë dhe parandalon rastet e konfliktit të interesit dhe zhvillon procesin e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë në Kosovë.¹⁶ Ekspertët ligjorë që merren me legjislacionin kundër korrupsionit në Kosovë, deklarojnë se nuk ka përplasje të kompetencave ligjore mes AKK-së dhe PK-së për sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit në vend.¹⁷

Në këtë drejtim, Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, përcakton obligimet e zyrtarëve të lartë publikë për të deklaruar pasurinë dhe të hyrat e tyre, si dhe prejardhjen e tyre, dhe obligimin e AKK-së për të kontrolluar pasurinë e deklaruar dhe prejardhjen e pasurisë, si dhe detyrimet e të gjithë zyrtarëve të lartë publik për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e dhuratave.¹⁸ Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, mos raportimi ose raportimi

10 Po aty, paragrafi 2 i nenit 1.

11 Po aty, nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1 të nenit 3.

12 Neni 1, Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>.

13 Po aty, neni 3.

14 Po aty, nënparagrafi 1.16 i paragrafit 1 të nenit 5.

15 Agjencia Kundër Korrupsionit. (2020). Raporti Vjetor i Punës (1 janar- 31 dhjetor 2019). Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsionit, fq. 5. Në dispozicion në: https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/03.%20Raporti_Vjetor_i_Punes_AKK_viti_2019_ver_final_ENG_AKK_Mars_2020.pdf.

16 Neni 5, Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2662>.

17 Intervistë, Ehat Miftaraj, Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, 1 korrik 2020.

18 Neni 1, Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>.

1.Korniza kushtetuese dhe ligjore për politikat kundër korrupsionit dhe për integritet

i rremë i pasurive, të ardhurave/të hyrave, dhuratave, përfitimeve të tjera materiale ose detyrimeve financiare, është vepër penale.¹⁹ Zyrtarët që shkelin detyrimet ligjore dënohen me gjobë ose me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet²⁰ varësisht nga lloji i shkeljeve të shkaktuara nga zyrtarët publikë. Në rastet kur ndodh kjo vepër, pasuritë, të hyrat, dhuratat ose përfitimet e tjera materiale të pa-raportuara ose të raportuara në mënyrë të rreme, konfiskohen.²¹ Vlen të përmendet se AKK-ja ka paralajmëruar hartimin e projektligjit të ri për prejardhjen dhe deklarimin e pasurisë, duke synuar zgjerimin e numrit të zyrtarëve publikë që deklarojnë pasuritë e tyre.²² INë këtë drejtim, vlerësohet se rreth 10,000 zyrtarë publikë potencialisht më të ekspozuar dhe të ndjeshëm ndaj korrupsionit, do të duhet t'i deklarojnë rregullisht pasuritë e tyre.²³ Sidoqoftë, projektligji nuk është miratuar ende nga Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, prandaj ligji aktual i miratuar në vitin 2011 është ende në fuqi.²⁴

Në vitin 2018, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e ri Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, duke shfuqizuar ligjin e mëparshëm për këtë çështje, i cili kishte mangësi në adresimin e rasteve të konfliktit të interesit mes zyrtarëve që mbajnë funksione publike dhe shërbejnë në kuadër të institucioneve publike.²⁵ Ky ligj synon të forcojë integritetin e sektorit publik, si dhe të garantojë ushtrimin e detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik, përmes identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit të zyrtarëve.²⁶ Siç u përmend më lart, bazuar në Kodin Penal të Republikës së Kosovës Nr. 06/L-074, konflikti i interesit është vepër penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim, në varësi të veprave penale të kryera nga një person zyrtar.²⁷ Bazuar në përkufizimin ligjor, konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.²⁸ Neni 7 i ligjit përkatës përcakton që çdo person që ka njohuri ose dyshim të arsyeshëm në lidhje me konfliktin e interesit të ndonjë zyrtari, duhet të njoftojë institucionin që e ka punësuar zyrtarin ose AKK-në.²⁹

19 Neni 430, Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

20 Po aty.

21 Po aty.

22 Intervistë, Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit, 12 qershor 2020.

23 Po aty.

24 Ligji Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2767>.

25 Instituti i Kosovës për Drejtësi. (2018). Ligji ndalon "fluturimin e supermenëve" me shumë pozita drejtuese dhe ndalon përfitimet e mëdha të zyrtarëve publikë nga shtesat. Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi. Në dispozicion në: <https://kli-ks.org/en/eng-ligji-ndalon-fluturimin-e-supermeneve-me-shume-pozita-drejtuese-dhe-ndalon-perfitimet-e-medha-te-zyrtareve-publike-nga-shtesat/>.

26 Neni 1, Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>.

27 Neni 417, Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>.

28 Neni 6, Ligji Nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16314>.

29 Po aty, neni 7.

Kosova ka miratuar Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve në vitin 2018, i cili synon të mundësojë raportimet e sinjalizuesve për shkelje në sektorin publik dhe privat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.³⁰ Sipas përkufizimit të përcaktuar nga ligji, sinjalizues është “çdo person i cili raporton ose shpalos informacione për një kërcënim ose cenim të interesit publik në kontekstin e marrëdhënies së vet të punës në sektorin publik ose privat”.³¹ Ligji thotë që sinjalizimi mund të jetë i brendshëm (raportimi i informacionit tek punëdhënësi konsiderohet të jetë sinjalizim i brendshëm), i jashtëm (raportimi i informacionit tek një autoritet kompetent konsiderohet të jetë sinjalizim i jashtëm) ose publik (shpalosje e informacionit në media, OJQ, Internet, takim publik, ose ndonjë mënyrë tjetër që e shpalos publikisht informacionin konsiderohet si sinjalizim publik).³² Ndërkohë që ky ligj hyri në fuqi në 2 janar 2019, dispozitat në lidhje me sektorin privat kanë filluar të zbatohen që nga 2 janari 2020, përkatësisht një vit pasi ligji ka hyrë në fuqi.³³ Sidoqoftë, deri më sot (dhjetor 2020), institucionet e Kosovës, më saktësisht Ministria e Drejtësisë, nuk kanë arritur të përmbushin afatet ligjore kur flitet për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve,³⁴ Sipas ligjit përkatës, aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji duhej të nxirreshin brenda gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.³⁵ duke nënkuptuar që legjislacioni dytësor duhet të ishte nxjerrë dhe miratuar deri më 2 korrik 2019 nga Ministria e Drejtësisë. Sidoqoftë, vlen të përmendet se kjo e fundit ka hartuar Rregulloren për Procedurën për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, e cila nuk është miratuar ende.³⁶ Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe miratimi i Rregullores për Procedurën për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit janë përmendur edhe nga AKK-ja si sfida kyçe.³⁷

1.4. Legjislacioni për zyrtarët publikë / zyrtarët e lartë publikë

Një akt tjetër ligjor në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e konfliktit të interesit është Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i miratuar në vitin 2010 nga Kuvendi i Kosovës. Për pasojë, personeli civil i PK-së është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës

30 Neni 1, Ligji Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>.

31 Po aty, nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1 të nenit 3.

32 Ibid, Article 13.

33 Neni 32.

34 Shala G., dhe Bajraktari L. (2020). “Sinjalizim publik” për mos zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (analizë e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga institucionet publike). Prishtinë: Instituti i Kosovës për Drejtësi, fq. 11-13. Në dispozicion në: <https://kli-ks.org/sinjalizim-publik-per-mos-zbatimin-e-ligjit-per-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>.

35 Paragrafi 1 i nenit 30, Ligji Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18303>.

36 Po aty, fq. 11.

37 Agjencia Kundër Korrupsionit. (2020). Raporti Vjetor i Punës (1 janar- 31 dhjetor 2019). Prishtinë: Agjencia Kundër Korrupsionit, fq. 43. Në dispozicion në: https://akk-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikimet/Raporte/03.%20Raporti_Vjetor_i_Punes_AKK_viti_2019_ver_final_ENG_AKK_Mars_2020.pdf.

në fuqi.³⁸ Përkundër kësaj, zyrtarët policorë (që nënkupton personelin në uniformë të policisë) nuk llogariten si pjesë e Shërbimit Civil, kështu që marrëdhënia e tyre e punës rregullohet në përputhje me Ligjin e Punës, ligjet e veçanta, marrëveshjet kolektive ose rregulloret sektoriale.³⁹ Sidoqoftë, ky ligj është shfuqizuar pjesërisht përmes miratimit nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2019 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.⁴⁰ Ai synon të vendosë bazën ligjore për punësimin e zyrtarëve publikë në institucionet e Kosovës bazuar në meritat, integritetin moral, paanësinë dhe qëndrueshmërinë.⁴¹ Zyrtarët publikë, sipas këtij ligji, kategorizohen në katër grupe: i) të punësuarit e Shërbimit Civil (nëpunësit civilë), ii) të punësuarit e Shërbimit Publik, iii) të punësuarit e kabinetit, dhe iv) personeli administrativ dhe ndihmës.⁴² Zyrtarët policorë të PK-së dhe Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) përjashtohen nga ky ligj, megjithatë nuk është specifikuar se cilët të punësuar ose personel i IPK-së përjashtohen në mënyrë specifike nga ligji, prandaj ata janë kualifikuar si “funksionarë publikë me status të veçantë”,⁴³ Për më tepër, ky ligj parashikon që “marrëdhënia mes shtetit dhe funksionarit publik me status të veçantë... rregullohet plotësisht me një ligj të veçantë sektorial”.⁴⁴ por nuk specifikon se cili ligj i rregullon funksionarët publikë me status të veçantë ose nëse duhet të hartohet një ligj i ri për rregullimin e këtij lloji të personelit. Për më tepër, në rast se do të hartohet ligji i ri për funksionarët publikë me status të veçantë, në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk përcaktohen afate ligjore për hartimin e legjislationit të tillë. Është e rëndësishme të theksohet se ligjet përkatëse për shërbimin civil janë duke u zbatuar nga PK-ja, veçanërisht nga personeli i administratës policore.

Sidoqoftë, Ligji për Zyrtarët Publikë iu nënshtrua vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, e cila në korrik të vitit 2020 vendosi që disa nga dispozitat e tij nuk janë në përputhje me dispozitat e Kushtetutës së Kosovës.⁴⁵ Sipas këtij aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, ligji përkatës për zyrtarët publikë nuk duhet të jetë i zbatueshëm për disa institucione specifike, pasi që shkel pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë, ndërsa Kuvendi i Kosovës është i detyruar nga ky vendim që të ndërmarrë veprimet për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.⁴⁶ Përkundër kësaj, Ligji për Zyrtarët Publikë nuk i shkel dispozitat e Kushtetutës kur bëhet fjalë për nëpunësit civilë të PK-së.⁴⁷

Një ligj tjetër i ri i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2019, është Ligji Nr. 06/L-111

38 Paragrafi 5 i nenit 3, Ligji Nr. 03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2679>.

39 Po aty, paragrafi 1 i nenit 4.

40 85, Ligji Nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>.

41 Po aty, neni 1.

42 Po aty, paragrafi 2 i nenit 2.

43 Po aty, nënparagrafi 3.3 i paragrafit 3 të nenit 3.

44 Po aty, paragrafi 4 i nenit 3.

45 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës / Aktgjykim në rastin nr. KO203/19 – Vlerësim i kushtetutshmërisë së neve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, 9 korrik 2020, fq. 53. Në dispozicion në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/ko_203_19_agj_ang.pdf.

46 Po aty.

47 Po aty.

për Pagat në Sektorin Publik, i cili përcakton i) sistemin e pagave dhe shpërblimeve për Zyrtarët Publikë dhe Funkionarët të cilët paguhen nga buxheti i shtetit, duke përfshirë Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, ii) rregullat për përcaktimin e pagave për të punësuarit e ndërmarrjeve publike në Kosovë, dhe iii) kriteret për pagën kalimtare dhe përfitimet e tjera pas përfundimit të funksionit të funksionarëve publikë dhe funksionarëve publikë me status të veçantë, si dhe për ish-zyrtarët e lartë që i realizojnë të drejtat e tyre sipas ligjit përkatës.⁴⁸ Janë disa dispozita që synojnë posaçërisht PK-në. Bazuar në këtë ligj, zyrtarët policorë do të përfitojnë një shtesë të veçantë për ato detyra që kryejnë në sektorë ose operacione speciale që kanë rrezik për jetën e tyre⁴⁹ dhe kjo shtesë e veçantë nuk mund të jetë më e lartë se dyzet për qind (40%) e pagës bazë.⁵⁰ Ky ligj nuk ka specifikuar se cilat pozita të zyrtarëve policorë do të përfitojnë nga shtesa të veçanta, të cilat duhet të përcaktohen me akt nënligjor nga Qeveria e Kosovës me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme.⁵¹ Deri më sot (dhjetor 2020), nuk është i disponueshëm publikisht asnjë informacion nëse për këtë çështje është nxjerrë dhe miratuar një akt nënligjor ose ndonjë legjislacion dytësor nga Qeveria/Ministria e Punëve të Brendshme. Neni 31 i Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik ka paraparë që aktet nënligjore të parashikuara nga ky ligj do të miratohen brenda nëntë muajsh pas botimit të ligjit në Gazetën Zyrtare, i cili ndodhi më 1 mars 2019, ndërsa këto akte nënligjore duhet të ishin miratuar deri më 1 dhjetor 2019.⁵²

Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka dal me përfundimin se ky ligj në tërësinë e tij nuk është në përputhje me disa nene të Kushtetutës së Kosovës,⁵³ prandaj u shpall i pavlefshëm në tërësinë e tij.⁵⁴

48 Neni 1, Ligji Nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18683>.

49 Po aty, paragrafi 1 i nenit 14.

50 Po aty, paragrafi 2 i nenit 14.

51 Po aty, paragrafi 2 i nenit 14.

52 Po aty, neni 31, Ligji Nr. 06/L-111.

53 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës / Aktgjykim në rastin nr. KO219/19 – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik, 9 korrik 2020, fq. 123. Në dispozicion në: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/07/gjk_ko_219_19_agj_ang.pdf.

54 Po aty.

2. LEGJISLACIONI PËR INTEGRITETIN NË POLICINË E KOSOVËS

Pjesa e dytë e raportit analizon në mënyrë specifike legjislacionin parësor dhe dytësor të PK-së në fushën e integritetit dhe parimet themelore të llogaridhënies që synojnë të forcojnë masat kundër korrupsionit, si dhe parandalimin dhe luftimin e korrupsionit policor.

Para analizimit të integritetit të policisë nga pikëpamja ligjore, vlen të përmenden dispozitat ligjore që ka paraparë për PK-në Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123. Neni 69 i Kodit të Procedurës Penale përcakton që PK-ja i heton veprat e mundshme penale për të përcaktuar nëse kërkohet një procedim penal, ndërsa prokurori dhe policia punojnë së bashku gjatë hapave fillestarë.⁵⁵ Për më tepër, sapo të autorizohet një masë ose të fillojë një procedim penal, prokurori drejton dhe mbikëqyr punën e policisë dhe/ose organit tjetër që zhvillon hetimin penal, duke pasur parasysh që prokurori ka qasje në të gjitha informacionet përkatëse hetimore që i posedon policia gjatë hapave fillestarë.⁵⁶ Përveç kësaj, me marrjen e informacionit për një vepër të dyshuar penale, policia heton nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm se është kryer një vepër penale e ndjekur penalisht ex-officio.⁵⁷ Policia gjithashtu i heton veprat penale dhe ndërmerr hapat e nevojshëm për gjetjen e kryesit, për të parandaluar që autori i krimit ose bashkëpunëtori i tij/saj të fshihet ose të arratiset, për të zbuluar dhe ruajtur gjurmët dhe provat e tjera të veprës penale dhe sendet që mund të shërbejnë si provë, dhe për të mbledhur të gjitha informacionet që mund të jenë në përdorim në procedurën penale. Në lidhje me IPK-në, është e rëndësishme të theksohet se hetuesit e këtij institucioni kanë kompetenca policore; prandaj edhe ata i ushtrojnë detyrat e tyre në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.⁵⁸

2.1. Korniza ligjore e Policisë së Kosovës

Ligji aktual (Nr. 04/L-076) për Policinë, sipas të cilit funksionon ky institucion, u miratua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2012. Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e policisë, organizimin e saj dhe çështje të tjera që lidhen me aktivitetet dhe veprimet e PK-së.⁵⁹

Ligji fillon me parimet udhëzuese të punës së PK, të cilat ndër të tjera përfshijnë: trajtimin

55 Neni 69, Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

56 Po aty.

57 Po aty, neni 70.

58 Neni 17, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720>.

59 Neni 1, Ligji Nr. 04/L-76 për Policinë. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2806>.

e barabartë dhe të drejtat e të gjithë personave; respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore; paanshmërinë dhe neutralitetin lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave; integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjësinë në shërbimin publik; transparencën - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut; legjitimitetin, përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin; përkushtimin ndaj punësimit, avancimit dhe caktimit të detyrave në mënyrë gjithëpërfshirëse, meritore dhe pa diskriminim, duke reflektuar karakterin shumetnik në Republikën e Kosovës dhe duke i njohur parimet e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut të parapara në Kushtetutë.⁶⁰ Në këtë drejtim, zyrtarët policorë i ushtrojnë autorizimet e tyre dhe i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ligjshme, bazuar në Kushtetutën dhe në Kodin e Etikës të Policisë.⁶¹

Ligji vazhdon duke përcaktuar edhe statusin e PK-së si një shërbim publik që operon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme⁶² përmes një zinxhiri komandues të unifikuar në të gjithë territorin e Kosovës.⁶³ PK-ja vepron nën autoritetin e Ministrit të Punëve të Brendshme dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, ndërsa autoriteti i Ministrit nuk përfshin menaxhimin operacional të policisë. Sidoqoftë, Drejtori i Përgjithshëm i policisë raporton dhe i përgjigjet drejtpërdrejt Ministrit për administrimin dhe menaxhimin e policisë. PK-ja ka buxhetin e vet, i cili është një buxhet i veçantë brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.⁶⁴ Për më tepër, Drejtori i Përgjithshëm i PK-së ka të drejtë të përgatisë buxhetin e policisë dhe t'ia paraqesë Ministrit për shqyrtim dhe përpunim të mëtejshëm në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj.⁶⁵ Në këtë drejtim, PK-ja është përgjegjëse për zbatimin dhe menaxhimin e buxhetit të vet.⁶⁶

Kur merren parasysh politikat e integritetit në kuadër të PK-së, ky ligj ka paraparë që të gjitha shkeljet disiplinore që kanë të bëjnë me personelin e PK-së, përveç rasteve të parapara nga Ligji për IPK-në, hetohen dhe vendosen nga PK-ja.⁶⁷ ndërsa shkeljet, masat dhe procedurat rregullohen nga aktet nënligjore të policisë.⁶⁸

Ligji për Policinë ka disa dispozita specifike për konfliktin e interesit. Aty theksohet se zyrtari policor nuk duhet të pranojë një pozitë ose detyrim dhe nuk duhet të marrë pjesë në ndonjë funksion ose aktivitet, që krijon një konflikt interesi me detyrat zyrtare të policisë,⁶⁹ duke iu referuar situatave specifike të cilat duhet të shmangen nga stafi i saj, të tilla si: i) emërimi apo zgjedhja në detyrë publike apo pozitë tjetër qeveritare; ii) pjesëmarrja në fushata elektorale për zgjedhje në detyrë publike; iii) punësimi, apo pjesëmarrja në çfarëdo aktivitet biznesi për kompensim, përveç me leje të dhënë

60 Po aty, paragrafi 1 i nenit 2.

61 Po aty, paragrafi 2 i nenit 2.

62 Po aty, paragrafi 1 i nenit 4.

63 Po aty, paragrafi 3 i nenit 4.

64 Po aty, paragrafi 1 i nenit 51.

65 Po aty, paragrafi 2 i nenit 51.

66 Po aty, paragrafi 3 i nenit 51.

67 Po aty, paragrafi 1 i nenit 43.

68 Po aty, paragrafi 2 i nenit 43.

69 Po aty, paragrafi 1 i nenit 49.

2. Legjislacioni për integritetin në Policinë e Kosovës

nga Drejtori i Përgjithshëm; iv) pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike, ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore; paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore, ndërkohë që anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesit dhe v) dhënia e deklaratave publike apo komenteve lidhur me punën e policisë, përveç në raste kur lejohet nga eprori me autorizim të duhur.⁷⁰

Për sa i përket personelit të vet, PK numëron tri kategori të personelit të vet: i) zyrtarë policorë që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore, ii) stafi civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtroj autorizime policore, dhe iii) kadetë policorë.⁷¹ Zyrtarët policorë në Kosovë gëzojnë të njëjtat të drejta civile dhe politike si qytetarët e tjerë, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve në këtë ligj që janë të nevojshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe detyrave policore në shoqërinë demokratike.⁷² Ata gjithashtu kanë të njëjtat të drejta sociale dhe ekonomike si nëpunësit e tjerë publikë, siç janë e drejta për të organizuar apo për të marrë pjesë në organizata përfaqësuese dhe t'i pranojnë shpërblimet e duhura, sigurimin social, ndihmën juridike, beneficione shëndetësore dhe beneficione të tjera për punën e tyre.⁷³ Sidoqoftë, zyrtarët policorë nuk kanë të drejtë të bëjnë grevë, por kanë të drejtë të shprehin pakënaqësinë e tyre përmes protestave të organizuara dhe të udhëhequra nga organet e tyre përfaqësuese.⁷⁴

Nga ana tjetër, IPK-ja është institucioni kryesor në Kosovë përgjegjës për forcimin e integritetit të policisë, masat kundër korrupsionit dhe luftimin e aktiviteteve kriminale dhe të paligjshme në të cilat janë përfshirë PK-ja dhe zyrtarët policorë. Misioni i IPK-së përfshin ushtrimin e detyrave të veta që të sigurojë një shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.⁷⁵ Ai operon si një institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe është i pavarur nga PK-ja, megjithatë nën vartësinë e drejtpërdrejtë të Ministrit.⁷⁶ Kompetencat më të rëndësishme ligjore dhe fushëveprimi që ligji i jep IPK-së në lidhje me PK-në janë parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga të punësuarit e PK-së, pavarësisht nga niveli dhe pozita, gjatë kohës që janë në detyrë ose jashtë detyrës.⁷⁷ Më shumë detaje mbi integritetin, pavarësinë, punën dhe aktivitetet e IPK-së kundrejt PK-së do të analizohen në një raport tjetër të QKSS-së që do të botohet më 2021.

70 Po aty, paragrafi 2 i nenit 49.

71 Po aty, paragrafi 1 i nenit 44.

72 Po aty, paragrafi 1 i nenit 46.

73 Po aty, paragrafi 2 i nenit 46.

74 Po aty, paragrafi 3 i nenit 46.

75 Neni 3, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720>.

76 Po aty, paragrafi 1 i nenit 6.

77 Nënparagrafi 1.1 i paragrafit 1 të nenit 2, Ligji Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2720>.

2.1.1. Aktet nënligjore të Policisë së Kosovës

Legjislacioni dytësor ose aktet nënligjore të policisë janë dokumente të rëndësishme ligjore për të përcaktuar dhe rregulluar më tej fushën dhe performancën e institucionit dhe personelit të tij civil dhe në uniformë. Ky raport ofron një pasqyrë të shkurtër të akteve nënligjore të policisë. Një zhvillim pozitiv është se policia kohët e fundit i ka publikuar aktet nënligjore në faqen e vet të internetit, siç është rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme nga QKSS-ja viteve të fundit në mënyrë që policia të demonstrojë transparencë, si një nga parimet kyçe të integritetit. Sidoqoftë, është ende e paqartë nëse janë botuar të gjitha rregulloret dhe udhëzimet administrative (të cilat përbëjnë legjislacionin dytësor) apo jo, pasi që vetëm një numër i caktuar i tyre janë të disponueshme në ueb faqen e policisë.⁷⁸

Rregullorja Nr. 02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të PK-së, e cila hyri në fuqi në fillim të vitit 2017, përcakton organizimin e brendshëm të policisë në nivelin qendror dhe lokal.⁷⁹ Një rregullore tjetër e policisë që rregullon burimet njerëzore është Rregullorja për Personelin dhe Administratën e PK-së, e cila është në fuqi që nga shtatori 2019, duke e shfuqizuar rregulloren e mëparshme.⁸⁰ Ajo përcakton rregullat dhe detyrat për personelin civil dhe në uniformë të policisë, përfshirë zyrtarët policorë. Nga ana tjetër, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2018 për Marrëdhëniet e Punës në PK, i cili hyri në fuqi në nëntor 2018, rregullon marrëdhënien e punës për personelin e policisë dhe është e zbatueshme për të gjithë personelin e policisë.⁸¹ Në korrik 2020 është ka hyrë në fuqi udhëzimi i ri administrativ mbi procedurën e gradimit për zyrtarët policorë. Ai përcakton kriteret për pjesëmarrje në gradim, mënyrën e aplikimit, përbërjen e komisionit dhe paneleve vlerësuese, testimin, mënyrën e vlerësimit, procedurat e ankimit, dhënien e gradës dhe caktimin në pozitë, në procesin për gradimin e zyrtarëve policorë.⁸²

Një rregullore e rëndësishme në lidhje me integritetin e policisë është në mënyrë të pashmangshme Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në PK. Ajo synon të përcaktojë politikat në lidhje me disiplinën, shkeljet, masat disiplinore dhe procedurat në lidhje me aktivitetet e personelit të policisë, dispozitat ligjore dhe kërkesat specifike të policisë në fushën e disiplinës.⁸³ Për më tepër, kjo rregullore përcakton çështjet e mëposhtme: raportimi i shkeljeve

⁷⁸ Për më shumë informacion shihni këtë vegëz: <https://www.kosovopolic.com/dokumente/akte-te-brendshme-te-policise-rregulloret-udhezimet-administrative/>.

⁷⁹ Neni 3, Rregullore (MPB) Nr. 02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13324>.

⁸⁰ Neni 255, Rregullore për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/1.-Rregullorja-e-Personel-dhe-Administrate%CC%88.pdf>.

⁸¹ Neni 2, Udhëzim Administrativ Nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/08/02-2018-Mbi-marre%CC%88dhe%CC%88nien-e-pune%CC%88s-ne%CC%88-Policine%CC%88-e-Kosove%CC%88s.pdf>.

⁸² Neni 1, Udhëzim Administrativ Nr. 02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policorë. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/02-2019-U.A.-pe%CC%88r-Procedure%CC%88n-e-gradimit-pe%CC%88r-zyrtare%CC%88t-policore%CC%88-final-03.07-2019.pdf>.

⁸³ Neni 1, Udhëzim Administrativ Nr. 04/2019 për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore në Policinë e Kosovës. Në

2. Legjislacioni për integritetin në Policinë e Kosovës

disiplinore, procedurat e fillimit të procedurave disiplinore, procedura e hetimit, pushimi i procedurës disiplinore, procedura e suspendimit, procedura e transferimit, procedura për ndërprerjen e hetimit, procedura e vendimmarrjes dhe procedura e ankimit kundër vendimeve disiplinore dhe administrative.⁸⁴

Që nga viti 2020, PK-ja ka filluar procesin e hartimit të Rregulloreje së re për Integritetin në Policinë e Kosovës, duke synuar krijimin e rregullave, procedurave dhe metodave për parandalimin e korrupsionit, keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe sjelljeve të tjera jo-etike që dëmtojnë integritetin e policisë.⁸⁵ Ky akt nënligjor do të adresojë edhe parandalimin e konfliktit të interesit në kuadër të PK-së, si dhe sinjalizimin e brendshëm të institucionit, ndërsa do të jetë i zbatueshëm për të gjithë personelin e PK-së. Deri më tani, nuk ka informacion të disponueshëm nëse Rregullorja është miratuar nga institucionet përkatëse.

dispozicion në: <https://www.kosovopolicice.com/wp-content/uploads/2020/07/UA-Nr.04-2019-Shkeljet-masat-dhe-procedura-diciplinore.pdf>.

84 Po aty, neni 4.

85 Draft Rregullorja për Integritetin në Policinë e Kosovës, 2020.

3. DOKUMENTET STRATEGJIKE PËR NGRITJEN E INTEGRITETIT NË POLICINË E KOSOVËS

Përveç kornizës ligjore që rregullon çështjet e integritetit, Policia e Kosovës (PK) ka miratuar disa strategji që ofrojnë masa specifike për zhvillimin e mëtejshëm të integritetit të institucionit. Një nga strategjitë kyçe në këtë drejtim është Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës,⁸⁶ e cila adreson në mënyrë specifike çështjet e integritetit dhe ofron masa për forcimin e fushave të ndryshme që janë potencialisht të cenueshme dhe mund të ndikojnë në integritetin e institucionit. Nga ana tjetër, strategji të tilla si **Plani Zhvillimor Strategjik** dhe **Strategjia e Policimit në Bashkësi**, ndër të tjera, ofrojnë masa dhe veprime konkrete në fushat e identifikuar si të cenueshme në planin e integritetit, dhe rrjedhimisht ato i adresojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi çështjet që lidhen me integritetin e PK-së.

Të tre dokumentet strategjike janë miratuar në procese jo të ndërlidhura mes vete, dhe periudhat e zbatimit ndryshojnë nga njëra-tjetra. Megjithatë, arsyeja e fokusimit në këto dokumente është se këto strategji adresojnë aspekte të ngjashme dhe të rëndësishme për forcimin e integritetit në PK. Përkatësisht, teksa ka dokumente të tjera strategjike që parashikojnë masa për elemente të ndryshme të integritetit në PK, raporti fokusohet vetëm në këto tre strategji për dy arsye kyçe: përgjegjësia për hartimin dhe zbatimin e strategjive përkatëse bie drejtpërdrejt te vetë PK-ja, dhe ato trajtojnë aspekte që ekskluzivisht lidhen me integritetin dhe performancën e Policisë në përgjithësi.

3.1. Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës

Në vitin 2017, PK-ja miratoi “Planin për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës” (Plani i Integritetit). Ky dokument ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale të integritetit dhe masat për parandalimin e cenueshmërive të integritetit në PK për periudhën 2018-2019.⁸⁷ HAndaj, ky plan nuk është më valid, dhe PK-ja nuk ka zhvilluar ende një plan të ri që do të mbulonte periudhën aktuale dhe vitet pasuese. Zyrtarët e PK-së treguan se PK-ja do ta përditësojë përkohësisht planin ekzistues të integritetit, përpara se të nisë një proces të ri hartimi vitin e ardhshëm.⁸⁸ Sidoqoftë, kjo mund të jetë kryesisht spekulative, pasi PK nuk ka dhënë asnjë konfirmim zyrtar në lidhje me këto zhvillime për publikun.

⁸⁶ Në tekstin e mëtejme “Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës” do të referohet si “Plani i Integritetit”.

⁸⁷ Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2018-2019.

⁸⁸ Vëzhgim pjesëmarrës në procesin e hartimit të Rregullores së Integritetit të PK-së.

Në aspektin e përmbajtjes, plani i integritetit trajton çështjet kyçe dhe të rëndësishme të integritetit në kuadër të PK-së. Përmes planit të integritetit, PK-ja synon të sigurojë menaxhim efektiv të riskut të shkeljeve të mundshme të integritetit në kuadër të PK-së; të zvogëlojë mundësitë e korrupsionit të zyrtarëve të vet; të sigurojë qëndrueshmëri organizative ndaj korrupsionit; t'i standardizojë praktikatat e integritetit me kornizat, nevojat dhe kërkesat ligjore lokale dhe ndërkombëtare; dhe të rrisë më tej kapacitetet e PK-së për parandalimin e risqeve ndaj integritetit të organizatës.⁸⁹ Zonat në risk për shkelje të mundshme të integritetit, plani i integritetit i ka identifikuar dhe kategorizuar në pesë grupe: 1) aspektet organizative; 2) kultura organizative; 3) risqet dhe cenueshmëritë specifike; 4) prokurimi, dhe 5) komunikimi e informimi.⁹⁰

Aspektet organizative

Për të zvogëluar hapësirat potenciale të cenimit të integritetit në aspektin organizativ, plani i integritetit thekson si faktor të rëndësishëm mbikëqyrjen e zgjeruar dhe monitorimin e vazhdueshëm të ushtrimit të detyrave të policisë.⁹¹ Ai thekson nevojën për përmirësimin e zinxhirit të raportimit në njësitë organizative për të siguruar mbikëqyrje dhe auditim efektiv të vendimeve dhe detyrave të policisë.⁹² Planin i integritetit identifikon proceset e vlerësimit të performancës, gradimit dhe dhënies së gradës si potencialisht të cenueshme dhe vlerëson se këto procese kanë nevojë për transparencë të shtuar. Për të zvogëluar parregullsitë në vlerësimin e performancës, ngritjen në detyrë dhe gradimin, plani i integritetit parashikon avancimin e sistemit të rekrutimit, gradimit dhe ngirtjes në detyrë, dhe mbikëqyrjen e forcuar mbi këto procese.⁹³ Planin i integritetit thekson auditimin dhe inspektimet e brendshme si një aspekt tjetër organizativ që potencialisht mund të minojë integritetin institucional.⁹⁴ TRezultatet e anketës së brendshme të kryer për nevojat e Planit të Integritetit tregojnë se shumica e të anketuarve besojnë se inspektimet e brendshme për parandalimin e korrupsionit janë vetëm pjesërisht efektive në atë drejtim.⁹⁵ Prandaj, PK-ja ka parashikuar trajnime të vazhdueshme të ofruara nga ekspertë të jashtëm për zyrtarët e auditimit të brendshëm, dhe rishikimin e zbatimit të sistemit të auditimit të brendshëm/inspektimit për të siguruar kontrolle të brendshme gjithëpërfshirëse që e luftojnë korrupsionin në mënyrë efektive.

Kultura organizative

Kodi i sjelljes dhe etikës, lufta kundër korrupsionit dhe parandalimi i konfliktit të interesit, përbëjnë fushat që plani i integritetit thekson si bazë për sigurimin e një kulture organizative të bazuar në integritet.⁹⁶ Teksa plani i integritetit dhe kodi i sjelljes

89 Planin për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2018-2019, fq. 3.

90 Po aty, fq. 5.

91 Po aty, fq. 8.

92 Po aty.

93 Po aty.

94 Po aty, fq. 9.

95 Po aty.

96 Po aty.

dhe etikës konsiderohen faktorë kyç në forcimin e kulturës organizative, dhe nga ana tjetër plani i integritetit vazhdimisht thekson rritjen e transparencës dhe një qasje më pro-aktive në komunikimet me aktorët e jashtëm, asnjëri nga këta dokumentet nuk janë botuar nga PK-ja, dhe nuk janë të qasshëm për publikun. Ndërkohë që kodi i etikës është efektiv dhe i zbatueshëm për të gjithë zyrtarët policorë, plani i integritetit vëren se jo të gjithë zyrtarët policorë pasqyrojnë etikë dhe integritet të mirë brenda organizatës. Për ta adresuar këtë çështje, ai udhëzon departamentin e burimeve njerëzore të përditësojë planin e trajnimit me qëllim që të rritet vetëdijesimi për etikën dhe integritetin, dhe të sigurojë trajnim shtesë për zbatimin e kodit të etikës. Nga ana tjetër, megjithëse në praktikë korrupsioni dhe konflikti i interesit paraqesin kërcënim serioz për integritetin e organizatës, ato trajtohen në mënyrë sipërfaqësore në planin e integritetit. Ato janë analizuar shkurtimisht dhe janë kufizuar kryesisht në kuadrin e nevojës për ngritjen e vetëdijes dhe informimit më të mirë të zyrtarëve policorë për fenomene të tilla. Planin e integritetit sugjeron hartimin e planeve për trajnime kundër korrupsionit, sigurimin e platformave për t'i diskutuar hapur çështjet e korrupsionit, rritjen e vetëdijesimit brenda organizatës dhe rritjen e shpeshësisë së takimeve mes mbikëqyrësve dhe ekipeve të tyre për të prezantuar dhe diskutuar qëllimet strategjike dhe prioritetet kundër korrupsionit. Nevoja të ngjashme janë theksuar për parandalimin e konfliktit të interesit duke theksuar sigurimin e udhëzimeve dhe kriterëve më të mira për atë që konsiderohet si konflikt i interesit në kuadrin e PK-së. Sipas planit të integritetit, për ta parandaluar konfliktin e interesit, PK-ja duhet të përqendrohet veçanërisht në prokurimin, ekzekutimin e kontratave, hetimin e krimit dhe procesin e emërimit të bordeve për proceset e rekrutimit dhe gradimit.

Risqet dhe cenueshmëritë specifike, prokurimi dhe komunikimet

Siç thuhet në planin e integritetit, fushat më të cenueshme në PK janë: procesi i hetimeve, me theks në hetimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve ekonomike; siguria publike; kontrolli dhe menaxhimi i integruar i kufirit; shërbimet mbështetëse, të tilla si prokurimi, menaxhimi i aseteve dhe menaxhimi i buxhetit; dhe burimet njerëzore, posaçërisht rekrutimi, përzgjedhja, gradimi dhe shkarkimi i zyrtarëve.⁹⁷ Për t'i identifikuar dhe adresuar në mënyrë konsistente risqet specifike, PK-ja parashikon të integrojë vlerësimin periodik të riskut në këto fusha në raportimin e brendshëm për progresin e zbatimit të planit të veprimit të planit të integritetit. Në mënyrë të ngjashme me fushat e tjera, fushatat shtesë të trajnimit dhe informimit mbeten veprimet kryesore për sigurimin e integritetit edhe në këto fusha specifike. Siç përsëritet disa herë në planin e integritetit, forcimi i kontrollit të brendshëm konsiderohet si një hap i domosdoshëm për forcimin e integritetit në departamentet më të cenueshme, veçanërisht në departamentin e hetimit. Për më tepër, plani i integritetit parashikon rritjen e numrit të zyrtarëve policorë në departamentin e hetimeve. Nga ana tjetër, për të siguruar efektivitetin e procesit të prokurimit, PK-ja parashikon të ndryshojë rregullat dhe procedurat e brendshme për shërbimet mbështetëse, duke theksuar kontrollet dhe trajnimet e rritura në këtë drejtim. Për më tepër, plani i integritetit është shumë

97 Po aty, fq. 10.

sipërfaqësor në lidhje me komunikimet dhe informacionin, dhe përsërit nevojën për trajnim dhe mbikëqyrje të shtuar të brendshme. Aty thuhet që PK-ja duhet të jetë më pro-aktive për të siguruar përgjigje në kohë ndaj kërkesave për informacion nga media, organizatat joqeveritare dhe palët e tjera të interesit.

3.1.1. Mangësitë kryesore të Planit për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës

Plani i integritetit thekson vazhdimisht nevojën për rritjen e transparencës dhe kontrollit të brendshëm, veçanërisht në proceset e rekrutimit, gradimit dhe vlerësimit të performancës, por nuk parashikon masa konkrete në këtë drejtim. Masat kanë të bëjnë kryesisht me ngritjen e vetëdijes për çështjet e integritetit, pavarësisht nga fakti se vetëdija institucionale mbi integritetin duhet të ishte e vetëkuptueshme përmes kornizës ekzistuese ligjore dhe strategjive në nivelin kombëtar. Për më tepër, teksa theksohet vazhdimisht rritja e kontrollit të brendshëm, kjo nënkupton që sistemi i kontrollit të brendshëm nuk ka qenë efektiv deri më tani, dhe problemet e mundshme të integritetit në PK rrjedhin nga lart poshtë. Plani i veprimit i planit të integritetit ofron disa aktivitete për secilën fushë në risk të identifikuar. Këto aktivitete janë shumë të përgjithshme dhe si të tilla ato mund të perceptohen si masa ose fusha ku kërkohet përmirësim, por vështirë se mund të konsiderohen si aktivitete konkrete që ofrojnë përmirësime në fushat përkatëse. Për pasojë, plani i integritetit duhet të kishte siguruar aktivitete konkrete për secilën masë, në mënyrë që të specifikojë ndërhyrjen e drejtpërdrejtë që parashikohet të kryhet përmes planit të integritetit. Për krahasim, plani i integritetit i Forcës së Sigurisë së Kosovës specifikon nën-objektivat për secilin objektivi të përgjithshëm, nënvizon masat e përgjithshme për arritjen e objektivave, dhe ofron aktivitete konkrete për secilën masë të specifikuar.⁹⁸ Në këto rrethana, vlerësimi i zbatimit të planit të integritetit mund të jetë sipërfaqësor, pasi shumë nga masat nuk janë të matshme. Për shembull, shumë nga aktivitetet e planit të integritetit parashikojnë që të gjitha departamentet e PK-së duhet të rrisin vetëdijesimin për çështje të ndryshme, pa specifikuar se si do të zbatohet kjo në praktikë, ose cilët tregues përdoren për të vlerësuar zbatimin e aktiviteteve të tilla. Për më tepër, shumë aktivitete theksojnë forcimin e kontrolleve në departamente të ndryshme, pa specifikuar se si do të zbatohet kjo në praktikë - përmes rritjes së kapaciteteve njerëzore në mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme, avancimit të sistemit të komunikimit të brendshëm, ose zhvillimit të mekanizmave shtesë për mbikëqyrjen e brendshme.

Megjithëse plani i integritetit deklaron se ai shërben si një instrument shtesë për rritjen e integritetit institucional në nivelin kombëtar dhe plotëson zbatimin efektiv të planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit,⁹⁹ Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) nuk është përfshirë në procesin e hartimit të tij.¹⁰⁰ Po kështu, as

⁹⁸ Ministria e Mbrojtjes. Plani i Integritetit 2019-2022. Në dispozicion në: <https://mod.rks-gov.net/repository/docs/plani-i-integritetit-19-22-eng.pdf>.

⁹⁹ Plani i integritetit i referohet Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit 2013-2017. Meqenëse Qeveria e Kosovës nuk ka miratuar ende një Strategji të re Kundër Korrupsionit, aktualisht nuk ka një strategji të tillë.

¹⁰⁰ Avdiu, P. dhe Muji, A. (2017). Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në institucionet e sigurisë në Kosovë. QKSS, në

Ministria e Punëve të Brendshme, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), ose cilido institucion tjetër relevant përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së PK-së, nuk morën pjesë në përpilimin e planit të integritetit, megjithëse janë mekanizma thelbësorë për mbikëqyrjen e integritetit të PK-së.¹⁰¹ TGjetjet e planit u identifikuan plotësisht brenda institucionit përmes pyetësorëve të plotësuar nga zyrtarët policorë për të identifikuar fushat e cënueshme të integritetit dhe përmes intervistave të brendshme dhe grupeve të fokusit.¹⁰² Ndërkohë që sigurimi i integritetit të PK-së nuk është një përgjegjësi ekskluzive e vetë PK-së, dhe janë vendosur mekanizma të shumtë të jashtëm për ta mbikëqyruar atë, mungesa e përfshirjes së tyre në hartimin e planit të integritetit e minimizon efektin e tij. Një qasje gjithëpërfshirëse do të kontribuonte në një analizë më të detajuar të fushave në risk dhe do të krijonte hapësirë për përpilimin e aktiviteteve konkrete, bazuar në kapacitetet aktuale. Kështu, nëse shohim planin e veprimit të planit të integritetit, bashkëpunëtorët në zbatimin e aktiviteteve specifikohen vetëm në nivelin e brendshëm të departamenteve dhe njësive të ndryshme në kuadër të PK-së, por nuk është paraparë që ndonjë kontribut nga institucionet e tjera që mund të japin një kontribut efektiv në disa fusha.

3.2. Plani Zhvillimor Strategjik

Avancimi i menaxhimit dhe kapaciteteve të burimeve njerëzore janë fjalët kyçe të planit të integritetit dhe Planit Zhvillimor Strategjik - PZHS (2016-2020) dhe planit të tij të veprimit i cili ofron masa konkrete në këtë drejtim, përkundër faktit se ky dokument i paraprin planit të integritetit dhe të dy dokumentet nuk janë të harmonizuara me njëri-tjetrin.

Objektivi kryesor i PZHS-së është avancimi i burimeve njerëzore duke formuar zhvillimin e karrierës së zyrtarëve të PK-së bazuar në performancën e tyre, avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit, sigurimi i mbështetjes shëndetësore për zyrtarët e PK-së, dhe përmirësimi i cilësisë së programeve të trajnimit.¹⁰³

Për t'i përmbushur objektivat, PZHS-ja parashikon të përmirësojë cilësinë e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të ndërhyjë në zona potencialisht të cënueshme, siç janë proceset e gradimit dhe rekrutimit, duke i rishikuar dhe riorganizuar ato.¹⁰⁴ INë këtë drejtim, PK-ja e ka shfuqizuar Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2018 për Procedurat e Gradimit për Zyrtarë Policorë dhe ka miratuar Udhëzimin e ri Administrativ Nr. 01/2019 që e rregullon këtë proces. Ky veprim është një nga masat e parashikuara nga plani i veprimit i PZHS-së përveç rishikimit të strukturës organizative, e cila u përditësua me sukses në vitin 2019. Siç specifikohet në PZHS, ndryshimet në burimet njerëzore do të ndodhin edhe duke përditësuar listat e unifikuara të pozitive, në përputhje me listën e personelit të autorizuar dhe zbatimin e klasifikimit të vendeve të dispozicion në: http://www.qkss.org/repository/docs/Monitorimi_dhe_vleresimi_i_integritetit_ne_sektorin_i_sigurise_804909.pdf.

101 Po aty.

102 Plani për Forcimin e Integritetit në Policinë e Kosovës 2018-2019, fq. 4.

103 Policia e Kosovës. Plani Zhvillimor Strategjik 2016-2020. Në dispozicion në: https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2019/10/Plani_i_Strategjik_i_PK-se_-Shqip.pdf

104 Po aty.

punës për personelin civil. Për më tepër, përmes planit zhvillimor, PK-ja ka parashikuar operacionalizimin e skemës së pensionit të parakohshëm për personelin e PK-së dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor për zyrtarët e saj. Teksa masat e nevojshme në këtë drejtim janë ndërmarrë nga PK-ja, projektligji që i rregullon këto çështje është ende në pritje të aprovimit nga Qeveria e Kosovës.¹⁰⁵

3.3. Strategjia e Policimit në Bashkësi

Strategjia e Policimit në Bashkësi (SPB) 2017-2021 merret kryesisht me çështje të integritetit nga këndvështrimi i rritjes së transparencës dhe thellimit të partneriteteve me aktorët e jashtëm. Për t'i arritur objektivat strategjike të kësaj strategjie, PK-ja ka parashikuar takime të rregullta, projekte të përbashkëta, diskutime publike, ligjërata dhe fushata vetëdijesimi me departamentet komunale të arsimit, shkollat, mekanizmat lokalë të sigurisë, OJQ-të, mediat, komunitetet e biznesit, komunitetet kulturore etj.¹⁰⁶ Për më tepër, një nga masat që rrjedhin nga SPB-ja është dizajnimi i programeve trajnuese për anëtarët e PK-së dhe identifikimi dhe trajnimi i trajnerëve që i zbatojnë programet. Meqenëse plani i integritetit konsideron se Departamenti i Hetimit është i cenueshëm, PK-ja ka përfshirë priorizimin e rasteve dhe monitorimin e progresit të hetimeve të këtyre rasteve si një masë e rëndësishme për të rritur kënaqshmërinë dhe besimin në punën e policisë. Për më tepër, SPB-ja parashikon të rrisë transparencën e PK-së duke i publikuar profilet e Drejtorive Rajonale të Policisë dhe raportet e tyre periodike në ueb faqen zyrtare të PK-së. Teksa ueb faqja përfshin një profil të shkurtër të secilës Drejtori Rajonale, botimi i raporteve periodike nuk është zbatuar ende. Për të siguruar zbatimin e kësaj mase, PK-ja ka integruar emërimin e koordinatorit dhe ekipit monitorues në nivelin e drejtorisë së përgjithshme, inspektimet në terren për zbatimin e strategjisë dhe raportet vjetore të vlerësimit për zbatimin e strategjisë si një nën-objektiv i SPB-së. Raportet e vlerësimit për tre vitet e fundit nuk janë të qasshme për publikun.

Për dallim nga plani i integritetit, SPB-ja parashikon përfshirje më të gjerë të institucioneve të tjera në arritjen e objektivave të saj. Për më tepër, një nga objektivat e SPB-së është koordinimi dhe harmonizimi me strategjitë e tjera, megjithatë nuk theksohet harmonizimi me Planin e Integritetit. Megjithëse SPB-ja nuk e përmend planin e integritetit drejtpërdrejt, marrë parasysh fokusin e saj në bashkëpunim dhe transparencë, moszbatimi i SPB-së do të ndikonte në mënyrë të pashmangshme në zbatimin e planit të integritetit, marrë parasysh theksin e saj në rritjen e transparencës.

105 KOHA.net. (2020). Ka përfunduar draftligji për pensionimin e parakohshëm të policëve. Available at: <https://www.koha.net/arberi/202355/ka-perfunduar-draftligji-per-pensionimin-e-parakohshem-te-policëve/>

106 Policia e Kosovës. Strategjia e Policimit në Bashkësi 2017-2021. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolicë.com/wp-content/uploads/2019/10/1. Strategjia dhe Plani i Veprimt 2017-2021 - Policimi në Bashkësi -.pdf>

4. IMPLIKIMET NË INTEGRITET NGA ASPEKTET ORGANIZATIVE TË PK-SË

Plani i Integritetit i ka konsideruar elemente të caktuara të aspekteve organizative të PK-së si potencialisht të cënueshme në lidhje me cenimin e integritetit të institucionit. Fusha të ndryshme, të tilla si menaxhimi i buxhetit, efikasiteti i mekanizmave të mbikëqyrjes së brendshme në përpunimin e ankesave të qytetarëve, kujdesi shëndetësor, ushtrimi i pozitive, etj., i janë nënshtruar vazhdimisht inspektimeve dhe rekomandimeve për përmirësime nga mekanizmat e mbikëqyrjes së jashtme, të tilla si IPK-ja dhe Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA). Kohët e fundit, aspektet organizative u bënë arsyeja e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së. Sipas Kryeministrit të Kosovës, shkarkimi i Drejtorit të Përgjithshëm erdhi si rezultat i performancës jo të kënaqshme në udhëheqje, kontroll dhe mbikëqyrje të institucionit.¹⁰⁷ Për më tepër, sipas Kryeministrit, drejtori nuk ka arritur të përmbushë disa nga objektivat e Planit Zhvillimor Strategjik, duke vënë theksin në avancimin e burimeve njerëzore. Ai gjithashtu i referohet ndryshimit të paligjshëm nga Drejtori të organogramit të PK-së, megjithëse ndryshimi i organogramit në shtator 2019 u bë me miratimin e Ministrit të Brendshëm të atëhershëm, dhe ndryshimet në strukturën organizative janë paraparë edhe nga PZHS-ja.¹⁰⁸ Ky vendim u apelua nga ish-Drejtori dhe gjykata vendosi ta pezullojë përkohësisht procedurën për rekrutimin e Drejtorin e ri derisa një vendim përfundimtar i Gjykatës të përcaktojë ligjshmërinë e vendimit për shkarkimin e drejtorit.¹⁰⁹

Ky kapitull ofron një pasqyrë të funksionimit të elementeve të ndryshme të aspekteve organizative, përkatësisht Kontrolli i brendshëm, Menaxhimi i Buxhetit, Kujdesi shëndetësor, dhe Ushtrimi i pozitive në kuadër të PK-së. Analiza përfshin gjetjet nga raportet e institucioneve të mbikëqyrjes së jashtme dhe ofron një pasqyrë të aspekteve të ndryshme në këto fusha, siç është paraparë nga ligjet dhe rregulloret në fuqi.

107 Hoti tregon për shkarkimet në Polici, ATK e në Doganë. KosovaPress, 2020. Në dispozicion në: <https://kosovapress.com/%E2%80%8Bhoti-tregon-per-shkarkimet-ne-polici-atk-e-ne-dogane/>

108 Ekipi hulumtues i QKSS-së ka bërë përpjekje që përmes kontaktit me zyrën e Kryeministrit dhe Ministrin e Punëve të Brendshme, të marrë më shumë informacion në lidhje me këtë vendim dhe për të pasur qasje në raportin e performancës të përdorur si argument për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm, megjithatë nuk ka marrë përgjigje deri në datën e botimit të raportit.¹⁰⁹

L. Bajraktari (2020). Gjykata pezullon konkursin për drejtor të Përgjithshëm të Policisë, thotë se vendimi i Qeverisë për shkarkimin e Qalajt është në kundërshtim me Ligjin e Punës. Betimi për Drejtësi. Në dispozicion në: https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-pezullon-konkursin-per-drejtor-te-pergjithshem-te-policise-se-kosoves-thote-se-vendimi-i-qeverise-per-shkarkimin-e-qalajt-eshte-ne-kundershtim-me-ligjin-e-punes/?fbclid=IwAR0EaD0uLd0VggYF_HSqR47agyBnKbzyvV783DcAP-ST2bdnJLfOt-1Ghc9E

4.1. Internal Control

Mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë një nga organet më të rëndësishme dhe të ndjeshme të PK-së, funksionimi i duhur i të cilëve rrit nivelin e integritetit të policisë dhe forcon sundimin e ligjit në kuadër të institucionit. Mekanizmat e kontrollit të brendshëm përgjegjës për kryerjen e hetimeve disiplinore të PK-së veprojnë në kuadër të Divizionit për Standardet Profesionale (DSP), i cili bie në fushëveprimin e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm për Operativë.¹¹⁰ DSP-ja përbëhet nga tri njësi thelbësore:

- 1) Drejtoria e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimi të Sigurisë;
- 2) Njësia e Inspektimit; dhe
- 3) Njësia e sapo themeluar e Integritetit.

Drejtoria e Hetimeve të Brendshme dhe Kontrollit të Historikut është autoriteti vendimmarrës për shqyrtimin e çështjeve disiplinore ndaj zyrtarëve policorë.¹¹¹ Kurse Njësia e Inspektimit është përgjegjëse për mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të procedurave të zbatimit të vendimeve dhe detyrave policore sipas kornizës ligjore dhe akteve nënligjore në fuqi.¹¹² Nga ana tjetër, Njësia e Integritetit shqyrton rastet që nuk bien në fushëveprimin e Drejtorisë së Hetimeve të Brendshme, dhe as nuk paraqesin vepra penale të zyrtarëve policorë të cilat trajtohen nga IPK-ja, dhe përqendrohet në raste që potencialisht dëmtojnë imazhin e institucioni, përkatësisht dëmtojnë integritetin e tij.¹¹³ Për më tepër, ajo shërben si një pikë fokusi për sinjalizimin e brendshëm në përputhje me ligjin që rregullon çështje të tilla, si dhe një pikë fokusi për vlerësimin e brendshëm të konfliktit të interesit në rastet kur pala e përfshirë nuk është e sigurt nëse pjesëmarrja e tij/saj në punësim dytësor, procese të ndryshme, etj., përbën një konflikt interesi.¹¹⁴

Nga ana tjetër, Komisioni i Brendshëm Disiplinor (KBD) është mekanizmi përgjegjës për shqyrtimin e çështjeve të hetimit disiplinor, dhe nxjerr vendime për masa disiplinore, ndërsa ankesat e paraqitura pranë tij shqyrtohen nga Komisioni i Ankesave.¹¹⁵ IPërveç kësaj, Komisioni i Ankesave është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve administrative dhe çështjeve të tjera të punësimit.¹¹⁶ Të dy mekanizmat veprojnë nën Zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm për Burimet.¹¹⁷ Për më tepër, një mekanizëm tjetër që shërben si mekanizëm i kontrollit të brendshëm është Njësia/Drejtoria e Auditimit. Njësia/Drejtoria e Auditimit, ndër të tjera, monitoron punën e

110 Organigrami i Policisë së Kosovës.

111 Udhëzim Administrativ Nr. 04/2019 për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/UA-Nr.04-2019-Shkeljet-masat-dhe-procedura-diciplimore.pdf>

112 Rregullore për Operativë në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/Rregullore-pe%CC%88r-Operative%CC%88-te%CC%88-Policise%CC%88-se%CC%88-Kosove%CC%88s.pdf>

113 Vëzhgim pjesëmarrës në procesin e hartimit të Rregullores së Integritetit të PK-së.

114 Po aty.


115 Udhëzim Administrativ Nr. 04/2019 për shkeljet, masat dhe procedura disiplinore në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/UA-Nr.04-2019-Shkeljet-masat-dhe-procedura-diciplimore.pdf>

116 Po aty.

117 Organigrami i Policisë së Kosovës.

personelit të PK-së për të siguruar shërbime cilësore, vlerëson rregullisht punën e personelit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve nga PK-ja dhe njësitë e veta organizative, përkatësisht iniciacionin e masave korrigjuese kur është e nevojshme.¹¹⁸ Njësia e Auditimit funksionon nën fushëveprimin e Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.¹¹⁹

Figura 1 Organizimi i mekanizmave të mbikëqyrjes së brendshme në Policinë e Kosovës¹²⁰



4.1.1. Një përmbledhje e administrimit të rasteve disiplinore nga mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme

Në 2019, DSP-ja ka administruar 1,573 lëndë disiplinore, nga të cilat 846 ishin lëndë të hapura në vitin 2019 dhe 727 përfaqësojnë lëndët e bartura nga vitet e mëparshme.¹²¹ Këto lëndë mund të rrjedhin nga ankesat e drejtpërdrejta të qytetarëve të paraqitura në PK, mund të iniciohen në mënyrë të brendshme nga PK-ja, ose janë lëndë të transferuara nga IPK-ja kur ankesat e paraqitura në IPK nuk përfshijnë elemente penale por kanë të bëjnë me shkelje disiplinore. Numri i lartë i lëndëve të prapambetura vë në dyshim efikasitetin e DSP-së. Në këtë drejtim, inspektimet e IPK-së nga vitet e mëparshme kanë theksuar se arsyeja

118 Rregullore (MPB) Nr. 02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës.

119 Organigrami i Policisë së Kosovës.

120 Të dhënat për këtë figurë janë marrë nga Organogrami i Policisë së Kosovës dhe vëzhgimi pjesëmarrës në procesin e hartimit të Rregullores së Integritetit të PK-së.

121 Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës (2019). Në dispozicion në: <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-shqip.pdf>

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

kryesore për përpunimin e ngadaltë të lëndëve disiplinore është mungesa e personelit dhe caktimi i zyrtarëve policorë me grada joadekuate në pozitat në DSP, përkatësisht mungesa e burimeve të duhura profesionale. Ndërkohë, personeli i PK-së tregon pak interes për të qenë pjesë e kësaj divizioni, për shkak të ndjeshmërisë së detyrës.¹²² Në vitin 2017, DSP-ja kishte gjithsej 51 personel, nga të cilët 48 në uniformë dhe 3 personel civil.¹²³ Ndërsa bazuar në strukturën organizative dhe Listën e Personelit të Autorizuar (LPA), DSP-ja duhet të kishte gjithsej 58 personel. Teksa numri i personelit civil është në përputhje me LPA-në, ka mangësi në personelin në uniformë që shërbejnë si hetues në kuadër të DSP-së.¹²⁴ Ngjashëm me njësitë e tjera organizative të PK-së, IPK-ja ka identifikuar mangësi në shpërndarjen e gradave në përputhje me LPA-në. Në këtë drejtim, DSP-së i mungojnë 11 nivele të ndryshme për t'i plotësuar në mënyrë adekuate pozitat brenda DSP-së siç parashikohet nga LPA-ja.¹²⁵ Nga ana tjetër, KBD-ja ka shqyrtuar 1,197 lëndë, nga të cilat 852 u konsideruan të pabazuara.¹²⁶ Kështu, numri i madh i ankesave të pabazuara mund të jetë për shkak të pasigurive në lidhje me procedurat për raportimin dhe përpunimin e ankesave, qoftë nga qytetarët ose nga vetë zyrtarët policorë. Raportet për punën e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në Policinë e Kosovës dhe rezultatet që rrjedhin prej tyre janë përfshirë shkurtimisht në raportin vjetor të policisë, i cili në përgjithësi është i dobët në sigurimin e të dhënave që pasqyrojnë punën e policisë. Parregullsitë janë gjithashtu të pranishme në informimin e palëve në lidhje me procedurat disiplinore në përputhje me procedurat standarde operacionale. Sipas këtyre procedurave, hetuesi i procedurës disiplinore duhet të nxjerrë ftesë për zyrtarët policorë të dyshuar për shkelje dhe dëshmitarët e lëndës.¹²⁷ Inspektimet e IPK-së kanë theksuar se në disa raste nuk është nxjerrë asnjë ftesë e tillë me shkrim për zyrtarët policorë nën hetime dhe për dëshmitarët, ndërsa në rastet e tjera në të cilat janë nxjerrë ftesa, ato nuk kanë respektuar procedurat standarde për iniciimin, kryerjen dhe përfundimin e hetimit dhe verifikimet e së kaluarës, hetimet e brendshme në nivelin lokal, dhe menaxherin e lëndëve dhe bazës së të dhënave në DSP.¹²⁸ Për më tepër, në disa raste DSP-ja nuk ka arritur t'i përmbushë afatet e parashikuara për njoftimin e zyrtarëve policorë nën hetim për fillimin e hetimit dhe përfundimin e hetimeve, përkatësisht paraqitjen e lëndës në KBD.¹²⁹ Sidoqoftë, përkundër çështjeve teknike, IPK-ja ka vlerësuar se procedurat për përpunimin e ankesave zakonisht respektohen nga mekanizmat e mbikëqyrjes së brendshme në PK.¹³⁰ Duket se parregullsitë e përmendura vijnë nga neglizhenca dhe paaftësia e zyrtarëve policorë për zbatimin e procedurave të parashikuara, sesa nga natyra e shkeljeve serioze që mund të jenë të dëmshme për institucionin.¹³¹

122 Inspektorati Policor i Kosovës. (2018). Raport i inspektimit Nr. 09-2018 mbi menaxhimin e ankesave dhe hetimit disiplinor në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/03/RAPORT-I-INSPEKTIM-IT-MBI-MENAXHIMIN-E-ANKESAVE-DHE-HETIMIT-DISCIPLINOR.pdf>

123 Po aty.

124 Po aty.

125 Po aty.

126 Raporti Vjetor i Policisë së Kosovës (2019). Në dispozicion në: <https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-shqip.pdf>

127 Inspektorati Policor i Kosovës. (2018). Raport i inspektimit Nr. 09-2018 mbi menaxhimin e ankesave dhe hetimit disiplinor në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/03/RAPORT-I-INSPEKTIM-IT-MBI-MENAXHIMIN-E-ANKESAVE-DHE-HETIMIT-DISCIPLINOR.pdf>

128 Po aty.

129 Po aty.

130 Po aty.

131 Po aty.

4.2. Ushtrimi i pozitave zyrtare

Me 8,861 anëtarë, nga të cilët 7,850 janë personel me uniformë dhe 1,011 personel civil.¹³² tPK përbën një nga institucionet më të mëdha në vend. Organizimi i brendshëm i PK-së përcaktohet me Rregulloren (MPB) Nr. 02/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Pozitave të Punës të Policisë së Kosovës, e cila bazohet në Ligjin Nr. 04/L-076 për PK-në.¹³³ Për më tepër, Lista e Personelit të Autorizuar (LPA) është një dokument i brendshëm që mbështet organizimin e brendshëm duke përcaktuar kapacitetin e burimeve njerëzore, numrin e kërkuar të personelit, gradat dhe pozitat në PK për secilën njësi organizative.¹³⁴ Në këtë drejtim, IPK-ja ka hasur në parregullsi duke identifikuar që PK-ja nuk ka vendosur kriteret të qarta për ndryshimin e LPA-së bazuar në nevojat aktuale të divizioneve, drejtorive dhe departamenteve të PK-së.¹³⁵ Prandaj, numrat e personelit në departamentet e PK-së nuk përputhen me numrat e dhënë në LPA, rrjedhimisht shumë departamente të PK-së përballen me mungesë të burimeve njerëzore.¹³⁶

132 Të dhënat për personelin e PK-së u morën zyrtarisht nga PK-ja më 2 mars 2020.

133 Rregullore (MPB) Nr. 02/2017 për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=13324>

134 Inspektorati Policor i Kosovës. (2018). Raport i inspektimit Nr. 08-2018 mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës. Në dispozicion në: <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/10/Raport-i-Inspektimit-nr.-08-2018-Menaxhimi-i-Burimeve-Njerezore-ne-Policine-e-Kosoves.pdf>

135 Po aty.

136 Po aty.

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

Tabela 1 - Shpërndarja e personelit në departamentet e PK sipas LPA-së dhe praktikës aktuale për vitin 2017 (Burimi: IPK - Raport i inspektimit Nr. 08-2018 mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës)

Departamenti	Shpërndarja e Burimeve Njerëzore siç parashikohet nga LPA-ja			Shpërndarja aktuale e burimeve njerëzore			Diferenca në shpërndarje (+/-)
	Personel në uniformë	Nëpunës civilë	Gjithsej	Personel në uniformë	Nëpunës civilë	Gjithsej	
Drejtoria e Përgjithshme	177	35	212	154	36	190	-22
Departamenti i Operacioneve	5,761	701	6,462	5,578	660	6,328	-224
Departamenti për Kufi	1,272	44	1,316	1,279	43	1,322	+6
Departamenti i Hetimeve	597	27	624	574	23	597	-27
Departamenti për Burime Njerëzore	85	53	138	83	51	134	-4
Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse	5	250	255	11	260	271	+16
GJITHSEJ ¹³⁷	7,897	1,110	9,007	7,679	1,073	8,752	-255

Në mënyrë të ngjashme, IPK-ja ka vërejtur shpërndarje joadekuate të gradave në departamentet e PK-së, me disa departamente që përballen me mungesa në plotësimin e pozitave me personel me grada adekuate, ndërsa departamente të tjera e kanë tejkaluar numrin e gradave të parapara në disa pozita.¹³⁸ Në përgjithësi, nëse shpërndarja e personelit në pozita do të zbatohet në përputhje me LPA-në, PK do të kishte mungesë të 220 zyrtarëve policorë të gradave të ndryshme për të plotësuar pozitat sipas LPA-së.¹³⁹

¹³⁷ Ju lutemi vini re se të dhënat e paraqitura në tabelë paraqesin numrin e përgjithshëm të personelit të PK-së për vitin 2017, ndërsa të dhënat e paraqitura në fillim të kësaj pjese paraqesin numrin e përgjithshëm të personelit të PK-së për vitin 2019. Prandaj, ndryshimi në numrin e përgjithshëm të tabelës dhe të dhënave të dhëna në fillim të kësaj pjese janë të pranishme për shkak të kohës së ndryshme të marrjes së të dhënave dhe ndryshimeve që mund të kenë ndodhur në personelin e PK-së për shkak të proceseve të ndryshme mes viteve 2017 dhe 2019. Aktualisht nuk ka të dhëna të disponueshme për vitet 2019 ose 2020 për ndryshimin e shpërndarjes së pozitave sipas LPA-së dhe praktikës aktuale.

¹³⁸ Po aty.

¹³⁹ Po aty.

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

Tabela 2 - Shpërndarja e gradave në departamentet e PK-së sipas LPA-së dhe praktikës aktuale për vitin 2017 (Burimi: IPK - Raport i inspektimit Nr. 08-2018 mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në Policinë e Kosovës)

Departamenti	<i>Gjithsej siç parashikohet nga LPA-ja dhe praktika aktuale</i>	Kolonel	Nënkolonel	Major	Kapiten	Toger	Rreshter	Zyrtar policor
Drejtoria e Përgjithshme	LPA	5	8	12	9	30	57	56
	Real	6	6	9	9	24	53	44
	Diferenca (+/-)	+1	-2	-3	0	-6	-4	-12
Departamenti i Operacioneve	LPA	11	30	33	95	231	799	4,562
	Real	3	28	34	60	216	692	4,544
	Diferenca (+/-)	-8	-2	+1	-35	-15	-107	-18
Departamenti për Kufi	LPA	2	4	7	18	44	170	1,027
	Real	2	4	7	14	45	167	1,039
	Diferenca (+/-)	0	0	0	-4	+1	-3	+12
Departamenti i Hetimeve	LPA	2	10	5	27	63	126	364
	Real	0	9	5	16	67	196	280
	Diferenca (+/-)	-2	-1	0	-11	+4	+70	-84
Departamenti për Burime Njerëzore	LPA	3	6	6	12	8	35	15
	Real	2	6	5	7	10	33	19
	Diferenca (+/-)	-1	0	-1	-5	+2	-2	+4
Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse	LPA	/	1	/	1	0	2	1
	Real	/	1	/	2	2	2	3
	Diferenca (+/-)	0	0	0	+1	+2	0	+2
GJITHSEJ	LPA	23	59	63	162	376	1,189	6,025
	Real	13	54	60	108	364	1,143	5,929
	Diferenca (+/-)	-10	-5	-3	-54	-12	-46	-96

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

Edhe ZKA-ja ka theksuar parregullsi në këtë drejtim, për shkak të numrit të zyrtarëve policorë që mbajnë pozita që nuk janë në përputhje me gradën e tyre.¹⁴⁰ Për më tepër, parregullsitë kanë qenë të pranishme edhe në kompensimin financiar të këtyre zyrtarëve, të cilët vazhdojnë të marrin paga bazuar në pozitat e tyre, në kundërshtim me ligjin që rregullon kompensimin e zyrtarëve policorë në bazë të gradave.¹⁴¹ Sidoqoftë, për PK-në ky problem normalisht varet nga dinamika e institucionit. Proceset e gradimit në PK marrin kohë dhe procedurat e brendshme nuk lejojnë tejkalimin e numrit të paracaktuar të gradave.¹⁴² Si pasojë, për të kryer procese të gradimit për disa grada, zyrtarët policorë që i mbajnë ato gradë duhet të dalin në pension. Shumica e gradave të larta mbahen nga zyrtarë që janë shumë afër moshës së pensionit, ndërsa caktimi i tyre në detyra të caktuara dhe pozita të parapara për grada specifike do të ishte joefikas për performancën e institucionit.¹⁴³ Për më tepër, shumë prej zyrtarëve që mbajnë grada të caktuara kanë probleme shëndetësore dhe nuk mund të performojnë në mënyrë efikase në pozita të caktuara që kërkojnë gradat që mbajnë. Në mungesë të një ligji për pensionin e parakohshëm, kjo kategori e zyrtarëve duhet të vendoset në pozita që kërkojnë gradë më të ulët sesa mbajnë aktualisht, ndërsa pozita të caktuara duhet të plotësohen me grada më të ulëta se ato të parashikuara për këto pozita.¹⁴⁴ Sipas PK-së, problemi me ushtrimin e pozitave zyrtare është ndikuar edhe nga krijimi i Drejtorive Rajonale të Mitrovicës së Veriut dhe Gjakovës. Shtimi i dy drejtorive rajonale e ka detyruar PK-në të transferojë disa zyrtarë, të cilët ushtronin pozita në përputhje me gradat e tyre, nga Drejtoria e Përgjithshme dhe Drejtoritë e tjera Rajonale në dy drejtoritë e reja rajonale, duke krijuar kështu zbrazëti në pozitat që ata ushtronin para transferimi.¹⁴⁵

4.2.1. Pezullimi i pozitave si konflikt i mundshëm i interesit

Për vite, PK-ja ka qenë fleksibile në manovrimin me pozitat zyrtare. Në këtë drejtim, zyrtarët e lartë të PK-së kanë praktikuar pezullimin e pozitave të tyre në këtë institucion për të mundësuar angazhimin e tyre në institucione, organizata ose aktivitete të tjera, për t'u kthyer më pas në angazhimet e tyre të mëparshme në PK. Kështu, në vitin 2016, ish-shefi i Divizionit për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit në PK, e pezulloi pozitën e tij në PK për t'u emëruar si Kryeshf Ekzekutiv i IPK-së.¹⁴⁶ Emërimi i tij në organin kryesor të jashtëm të monitorimit të PK-së ka ngritur pikëpyetje mbi praninë e konfliktit të interesit.¹⁴⁷ AKK nuk gjeti elemente të konfliktit të interesit në rastin e Kryeshf Ekzekutiv të IPK-së, marrë parasysh që emërimi i tij ishte bërë në përputhje me dispozitat ligjore.¹⁴⁸ Në mënyrë të ngjashme, pas pezullimit të pozitave të tyre, shumë zyrtarë të tjerë të lartë

140 Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti Vjetor i Auditimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2019. Në dispozicion në: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/07/Raporti-i-auditimit-MPB-2019-Shqip.pdf>

141 Po aty.

142 Intervistë me ish Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së z. Rashit Qalaj, 22/05/2020.

143 Po aty.

144 Po aty.

145 Po aty.

146 Ahmeti, A. (2016). Drejtori i IPK-së Ruan Pozitën në Polici. Kallxo.com. Në dispozicion në: <http://kallxo.com/shkurt/drejtori-ipk-se-ruan-poziten-ne-polici/>

147 Po aty.

148 Ahmeti, A. (2016). AKK: Kreu i Inspektoratit nuk është në Konflikt Interesi. Kallxo.com. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/shkurt/akk-kreu-i-inspektoratit-nuk-eshte-ne-konflikt-interesi/>

janë kthyer në PK. Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, z. Samedin Mehmeti, ka punuar për organizata ndërkombëtare para se të kthehej në PK, ku ai ka kryer detyrën e Kryetarit të Komisionit të Brendshëm Disiplinor dhe Drejtorit të Divizionit të Trafikut Rrugor në Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së.¹⁴⁹ Për më tepër, edhe ish-Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, z. Shpend Maxhuni, e ka provuar praktikën e kthimit në PK pas angazhimit të tij 2 vjeçar si Udhëheqës i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, përkundër kritikave të shumta dhe parregullsive të udhëheqjes së tij të mëparshme në PK.¹⁵⁰ Sipas raportimit të mediave, angazhimi i tij i mëparshëm në PK është kritikuar në mënyrë aktive nga ish-Drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Rashit Qalaj, i cili në kohën kur ai mbante pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm e akomodoi z. Maxhuni si këshilltar të tij operacional pas kthimit të tij në PK.¹⁵¹ Sidoqoftë, ish-Drejtori i Përgjithshëm e konsideroi pezullimin e pozitave si të paarsyeshëm.¹⁵² Për këtë arsye, në vitin 2018, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ai inicioi ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili rregullonte pezullimin e pozitave.¹⁵³ Udhëzimi i ndryshuar specifikon që pezullimi i pozitës në PK mund të bëhet vetëm në rastet kur kjo është në interes të shtetit. Prandaj, kjo vlen në rastet kur zyrtari dërgohet të përfaqësojë vendin jashtë shtetit; nëse me vendim gjykate zyrtari dënohet me burgim deri në gjashtë muaj; dhe nëse në marrëveshje me institucionet shtetërore zyrtari caktohet për detyra tjera specifike.¹⁵⁴ Megjithatë udhëzimi administrativ është ndryshuar, zyrtarët që kanë pezulluar pozitën e tyre derisa udhëzimi i mëparshëm ishte në fuqi, mund të kthehen në PK në përputhje me dispozitat e udhëzimit paraprak administrativ - siç ka ndodhur me zyrtarët e përmendur në këtë paragraf. Edhe pse më parë ekipi hulumtues i QKSS-së ka bërë disa përpjekje për të pasur qasje në udhëzimin paraprak administrativ, ai nuk ishte i qasshëm për publikun, dhe publikut nuk i është ofruar asnjë informacion tjetër në lidhje me pezullimin e pozitave.

4.3. Menaxhimi i buxhetit

Qeveria e Kosovës ndan buxhetin e PK-së në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Drejtori i Përgjithshëm i PK-së është përgjegjës për hartimin e buxhetit të PK-së, i cili shqyrtohet dhe përpunohet më tej nga Ministri i Punëve të Brendshme.¹⁵⁵ Buxheti i PK-së menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme dhe alokimi i tij është pjesë e përgjegjësisë të Drejtorit të Përgjithshëm.¹⁵⁶ Pjesa më e madhe e buxhetit të PK-së është alokuar për paga dhe shtesa, e ndjekur nga shpenzimet për mallra dhe shërbime, shpenzimet

149 Biografia e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së. Në dispozicion në: <https://www.kosovopolic.com/en/about-us/deputy-general-director-of-kp/>

150 Kastrati, D. (2019). Shkëlqimi dhe rënia e Shpend Maxhunit. Kallxo.com. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/gjate/shkelqimi-dhe-renia-e-shpend-maxhunit/>

151 Rama, S. (2019). Shpend Maxhuni, këshilltar i drejtorit të Policisë nga i cili u kritikua për keqmenaxhim. Koha.NET. Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/200676/shpend-maxhuni-keshilltar-i-drejtorit-te-policise-nga-i-cili-u-kritikua-per-keqmenaxhim/>

152 Intervistë me ish Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së z. Rashit Qalaj, 22/05/2020

153 Po aty.

154 Udhëzim Administrativ Nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës.

155 Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës

156 Po aty.

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

kapitale, subvencionet dhe transferet, dhe shpenzimet komunale.¹⁵⁷ Në vitin 2018, PK-ja menaxhoi një buxhet të përgjithshëm prej 95,345,582 eurosh,¹⁵⁸ pasuar nga një rritje prej 0.8 për qind në vitin 2019, duke e çuar buxhetin në 96,077,535 euro.¹⁵⁹ Në vitin 2020, buxheti i PK-së arriti në gjithsej 96,701,309 euro,¹⁶⁰ duke nënvizuar një rënie të lehtë të trendit të rritjes nga vitet e mëparshme; buxheti i vitit 2020 është rritur me 0.6 për qind nga viti paraprak.

Sidoqoftë, tre vitet e fundit kanë pasur një buxhet dukshëm më të madh se tre vitet e mëparshme,¹⁶¹ duke krijuar kështu më shumë hapësirë për reformat e nevojshme në PK.

Table 3 - Total budget of KP for 2018,2019 and 2020 (Source: Laws on Budget Divisions for the Budget of the Republic of Kosovo, 2018,2019 and 2020)

Viti	2018	2019	2020
Buxheti i Përgjithshëm	95,345,582	96,077,535	96,701,309
Trendi i rritjes nga viti i kaluar	+8%	+0.8%	+0.6%

Ngjashëm me njësitë e tjera organizative, me mungesa të personelit përballet edhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave e PK-së në kuadër të Departamentit për Shërbime Mbështetëse. Teksa personeli i saj aktual konsiderohet të jetë i kualifikuar mirë, vëllimi i lartë i ngarkesës së punës në këtë departament është e vështirë të menaxhohet me kapacitetet aktuale.¹⁶² Për vite, IPK-ja dhe Zyra Kombëtare e Auditimit kanë theksuar problemet në menaxhimin e buxhetit që kanë rezultuar në ekzekutim të pjesshëm të buxhetit.¹⁶³ Mos shfrytëzimi i plotë i buxhetit është veçanërisht i theksuar në shpenzimet kapitale. Përdorimi joefikas i fondeve të alokuara për shpenzimet kapitale është rezultat i procedurave të zgjatura të prokurimit, vonesave të shkaktuara nga ankesat e operatorëve, etj.¹⁶⁴ Sidoqoftë, në vitin 2019 Qeveria e Kosovës mori një vendim që i mundësoi PK-së të fillojë tenderë me procedura të negociuara pa publikimin e kontratave, gjë që dukshëm ka përmirësuar performancën në ekzekutimin e buxhetit për shpenzimet kapitale.¹⁶⁵ Megjithëse ZKA-ja ka identifikuar përmirësime në këtë drejtim, në vitin 2019, shumica e shpenzimeve kapitale nuk ishin subjekt i auditimit, pasi 90% e atyre dosjeve ishin shpenzime që lidheshin me dokumente të klasifikuara.¹⁶⁶ Qasja në dokumentet e klasifikuara kërkon verifikim nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, ndërsa në kohën kur ZKA-ja e kishte audituar PK-në,

157 Ligji Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

158 Ligji Nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës.

159 Ligji Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

160 Ligji Nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

161 Për më shumë rreth alokimit të buxhetit të PK-së në 2015, 2016 dhe 2017, ju lutemi referojuni: http://www.qkss.org/repository/docs/Monitorimi_dhe_vleresimi_i_integritetit_ne_sektorin_i_sigurise_804909.pdf

162 Inspektorati Policor i Kosovës, 2019. Raporti Nr. 4/2019 për Menaxhimin e Buxhetit, Financave, Prokurimit dhe Logjistikës.

163 Po aty.

164 Intervistë me Zyrтарin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, 24/07/2020.

165 Po aty.

166 Po aty.

nuk kishte zyrtarë të licencuar nga AKI-ja. Sidoqoftë, sipas përfaqësuesve të ZKA-së, ata janë në proces verifikimi dhe certifikimi nga AKI, në mënyrë që inspektimet e ardhshme të PK-së të përfshijnë një mostër më të gjerë për auditim.¹⁶⁷ Verifikimi i zyrtarëve të ZKA-së, i cili do të hapte rrugën që auditorët e tyre të kontrollojnë kontratat e klasifikuara të institucioneve të sigurisë, është mjaft i vonuar.

Për më tepër, IPK-ja ka identifikuar devijime nga rregulloret që rregullojnë menaxhimin e parave të imëta nga PK-ja, duke qenë se është konstatuar se fondi i parave të imta është përdorur për të ekzekutuar pagesa që duhej të ekzekutoheshin rregullisht bazuar në kontrata/tenderë, si dhe janë gjetur raste të mosrespektimit të kohës së parashikuar për kompensimin e zyrtarëve të PK-së në rastet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit.¹⁶⁸ IPK-ja ka deklaruar se kjo vjen si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për menaxhimin e këtyre kategorive të shpenzimeve, prandaj ka rekomanduar rritjen e mbikëqyrjes së Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të PK-së.

4.4. Pengesat për kujdesin shëndetësor

Zyrtarët policorë të PK-së vazhdojnë të shërbejnë në këtë institucion pa ndonjë sigurim shëndetësor ose të jetës. Teksa sindikata e PK-së vazhdon të kërkojë sigurim shëndetësor, për aksidente dhe të jetës për zyrtarët policorë të PK-së, lëndimet dhe vdekjet gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare vazhdojnë të mbeten në mëshirën e ndihmës ad-hoc nga Qeveria e Kosovës.¹⁶⁹ Në vitet e fundit janë theksuar problemet me shëndetin mendor të zyrtarëve policorë. Në vitin 2018, IPK-ja i ka rekomanduar PK-së që të pezullojë 94 zyrtarë policorë për shkak të problemeve me shëndetin mendor.¹⁷⁰ Për kërkesën për pezullim, IPK-ja iu referua raporteve të vjetra mjekësore të zyrtarëve në fjalë; raporti më i fundit mjekësor për njërin nga këta zyrtarë ishte i vitit 2006, ndërsa në mesin e tyre kishte raporte nga periudha 2002-2003.¹⁷¹ Në këtë drejtim, pas rekomandimit të IPK-së, PK-ja i dërgoi këta zyrtarë për vlerësime të përditësuara mjekësore, të cilat nuk konfirmuan asnjë nga problemet mjekësore të paraqitura në raportet e vjetra.¹⁷² Kështu, rekomandimi u injorua nga Drejtoria e Përgjithshme e PK-së dhe zyrtarët vazhduan të ishin të angazhuar në PK.

Në vitin 2020, një zyrtare policore e PK-së vrau katër anëtarë të familjes së saj dhe u vetëvra. Para rastit, zyrtarja policore kishte kaluar kontrole të shumta psikologjike, që kishin rezultuar në rekomandime për t'ia konfiskuar armën për shkak të pamundësisë së saj për të ushtruar detyrat e pozitës që mbante.¹⁷³ Arma u konfiskua nga PK-ja dhe ajo vazhdoi të punonte në stacionin policor në detyra që nuk kërkojnë bartjen e pajisjeve policore.

167 Po aty.

168 Inspektorati Policor i Kosovës, 2019. Raporti Nr. 4/2019 për Menaxhimin e Buxhetit, Financave, Prokurimit dhe Logjistikës.

169 Fejzullahu, A. (2020). 20 vitet e Policisë së Kosovës pa sigurim shëndetësor. Kallxo.Com. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/lajm/20-vitet-e-policise-se-kosoves-pa-sigurim-shendetesor/>

170 Salihi, N. (2020). Papërgjegjësia e Rashit Qalajt për të suspenduar policët me probleme psikike shkaktoi tragjedinë në Gjilan. Insajderi. Në dispozicion në: <https://insajderi.com/papergjegjesia-e-rashit-qalajt-per-te-suspenduar-policet-me-probleme-psikike-shkakttoi-tragjedine-ne-gjilan/>

171 Intervistë me ish Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së z. Rashit Qalaj, 22/05/2020

172 Po aty.

173 ZONA B - Rashit Qalaj - 19.02.2020 - Klan Kosova, 2020. [Program televiziv] Klan Kosova.

4. Implikimet në integritet nga aspektet organizative të PK-së

¹⁷⁴ Sidoqoftë, vrasja u krye me armën zyrtare, të cilën ajo e kishte marrë në mënyrë të paligjshme nga stacioni policor përkatës. Zinxhiri komandues i stacionit policor u pezullua për shkak të neglizhencës që çoi në qasjen e zyrtares në armën e konfiskuar. ¹⁷⁵ Sidoqoftë, hetimet e IPK-së kanë arritur në përfundimin se përveç një nëpunësi civil të pezulluar në këtë rast, zyrtarët e tjerë nuk mbajnë asnjë përgjegjësi penale. ¹⁷⁶ Teksa për nëpunësin civil, IPK-ja ka dorëzuar një kallëzim penal në prokurori, zyrtarët e tjerë u kthyen në pozitë të tyre pas dy muajsh. ¹⁷⁷

Ish-Drejtori i Përgjithshëm i PK-së deklaroi se ka rreth 120 zyrtarë të PK-së që vuajnë nga sëmundje të ndryshme të rënda, duke përfshirë zyrtarë policorë që trajtohen për probleme të shëndetit mendor. ¹⁷⁸ Zyrtarët policorë trajtohen nga Drejtoria e Shërbimeve Shëndetësore të PK-së, dhe në varësi të gjendjes së tyre ata rekomandohen për shërbime shtesë mjekësore në spitalin privat të kontraktuar nga PK-ja. Për më tepër, ka pasur disa raste të zyrtarëve policorë të dërguar për trajtim jashtë vendit për shkak të mungesës së shërbimeve të nevojshme në Kosovë. ¹⁷⁹ Kostot e trajtimit të kujdesit shëndetësor për zyrtarët e PK-së zakonisht alokohen në formë të subvencioneve nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve nga buxheti i përgjithshëm i PK-së. ¹⁸⁰ Përveç kësaj, PK-ja ka krijuar nga njësi këshillimi në kuadër të drejtorive rajonale dhe drejtorisë së përgjithshme, për të këshilluar zyrtarët policorë për çrregullimin e mundshëm të stresit post-traumatik për shkak të natyrës së punës së tyre. ¹⁸¹ Në mungesë të ligjit për pension të parakohshëm dhe ligjit për trajtimin e invaliditetit, zyrtarët e PK-së që përballen me probleme të rënda shëndetësore janë të detyruar të vazhdojnë angazhimin e tyre në PK. Ish-Drejtori i Përgjithshëm i PK-së konsideroi se është detyrimi i tij profesional dhe personal t'i mbajë këta zyrtarë brenda sistemit, në mënyrë që të mund të garantojnë ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe trajtimeve nga PK-ja dhe t'u japin atyre ndjenjën e përkatësisë në sistem, në mungesë të kujdesit shëndetësor të mirëfilltë të institucionalizuar. ¹⁸² Teksa problemet e tyre shëndetësore janë edhe pengesa të mundshme për performancën efikase të zyrtarëve të tjerë, sipas ish-Drejtorit të Përgjithshëm, shkarkimi i tyre mund të paraqesë sfida më të mëdha për shkak të kostos së lartë të trajtimeve shëndetësore pa mbështetjen e PK-së. ¹⁸³ Megjithëse është hartuar projektligji për pension të parakohshëm për zyrtarët policorë të PK-së dhe të punësuarit e IPK-së me kompetenca policore, ai ende nuk është aprovuar nga Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës. Barra financiare mendohet të jetë arsyeja kryesore e dështimit në miratimin e projektligjit, megjithëse PK-ja ka siguruar një analizë mbi mënyrën më efikase të zbatimit, pa dëmtuar buxhetin dhe procesin operacional të PK-së. ¹⁸⁴

174 Po aty.

175 Hasani, G. (2020). Suspendohen për 72 orë komanda zinxhimore e stacionit policor në Gjilan. Gazeta Express. Në dispozicion në: <http://gazetaexpress.com/para-vrasjes-policija-e-ndjere-beri-dicka-per-te-cilen-ia-pane-sherrin-kolegett/>

176 Intervistë me Inspektoratin Policor të Kosovës, 27/05/2020.

177 Po aty.

178 ZONA B - Rashit Qalaj - 19.02.2020 - Klan Kosova, 2020. [Program televiziv] Klan Kosova.

179 Po aty.

180 Inspektorati Policor i Kosovës, 2019. Raporti Nr. 4/2019 për Menaxhimin e Buxhetit, Financave, Prokurimit dhe Logjistikës.

181 ZONA B - Rashit Qalaj - 19.02.2020 - Klan Kosova, 2020. [Program televiziv] Klan Kosova.

182 Po aty.

183 Po aty.

184 Koha.NET. (2018). Policia e Kosovës po mplaket. Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/71023/policia-e-kosoves-po-mplaket/>

REKOMANDIME

- Institucionet e Kosovës (Qeveria dhe Kuvendi) duhet që sa më shpejt të miratojnë legjislacionin e ri për deklarimin e pasurisë dhe legjislacionin dytësor për sinjalizimin, i cili do të kontribuonte më tej në parandalimin e korrupsionit në institucionet publike, përfshirë Policinë e Kosovës. Në këtë drejtim, policia duhet gjithashtu të miratojë Rregulloren për Integritetin dhe ta harmonizojë me kornizën aktuale ligjore në fushën e masave kundër korrupsionit.
- Institucionet qendrore dhe Kuvendi i Kosovës duhet të sigurojnë miratimin e ligjit për pension të parakohshëm dhe të ligjit për trajtimin e invaliditetit për zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, në mënyrë që të rritet efikasiteti i Policisë së Kosovës dhe të krijohet hapësirë për reformën e burimeve njerëzore në kuadër të institucionit;
- Policia duhet të përfshijë mekanizmat dhe institucionet e mbikëqyrjes së jashtme në hartimin e Planit të ri të Integritetit, në mënyrë që të sigurojë një qasje më gjithëpërfshirëse që do të kontribuonte në një analizë më të detajuar të zonave në risk dhe në hartimin e aktiviteteve konkrete për të forcuar integritetin në kuadër të institucionit, bazuar në kapacitetet aktuale;
- Marrë parasysh shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe argumentin që shkarkimi i tij rrjedh si rezultat i ndryshimit të paligjshëm të Organogramit të Policisë prej tij, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës duhet të sigurojnë informacione konkrete dhe të qarta për mënyrën si është e organizuar struktura organizative e policisë;
- Policia e Kosovës duhet të sigurohet që shpërndarja e burimeve njerëzore të bëhet bazuar në Listën e Personelit të Autorizuar, e cila përgatitet bazuar në nevojat aktuale dhe kapacitetet e Policisë së Kosovës;
- Në mënyrë që të adresohet problemi i shpërndarjes së burimeve njerëzore në departamentet e Policisë së Kosovës, duhet të rishikohen procedurat e brendshme, dhe duhet të rritet efektiviteti i proceseve të gradimit dhe dhënies së gradave. Raportet e mekanizmave të mbikëqyrjes së jashtme, siç janë Inspektorati Policor i Kosovës dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, duhet të bazohen në dinamikën e institucionit dhe mundësitë aktuale për shpërndarjen e burimeve njerëzore, bazuar në rregulloret dhe procedurat e brendshme të Policisë së Kosovës;
- Zyra Kombëtare e Auditimit duhet të sigurojë që zyrtarët e saj të marrin një leje sigurie nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, në mënyrë që ata të kenë mundësi të kontrollojnë kontratat e klasifikuara që përbëjnë një pjesë të madhe të ekzekutimit të buxhetit.

ISBN 978-9951-799-18-8



9 789951 799188